



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 shkurt 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Arsyeve për Vendimin mbi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë

T'u njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	6
III.	ÇËSHTJA PARAPRAKE	7
IV.	E KALUARA E TË AKUZUARVE	8
V.	KRITERET E RREGULLËS 94(2) DHE (5)	9
A.	Rregulla 94(2)	9
B.	Rregulla 94(5)(a)-(d) dhe (f)	10
C.	Rregulla 94(5)(e)	13
1.	Qasja e Trupit Gjykues	13
2.	Vlerësimi faktik	15
3.	Vlerësimi ligjor	16
4.	Përfundim	24
D.	Përfundim në lidhje me kriteret e rregullës 94(2) dhe (5)	24
VI.	PËRCAKTIMI I DËNIMIT	25
A.	Parashtrimet e palëve	25
1.	ZPS-ja	25
2.	Mbrojtja e Shalës	29
3.	Mbrojtja e Januzit	30
4.	Mbrojtja e Bahtijarit	32
B.	Korniza ligjore	33
C.	Konstatime	38
1.	Z. Shala	38
2.	Z. Januzi	40
3.	Z. Bahtijari	44
VII.	ZHDËMTIMET	47
A.	Vendimi i 29 janarit 2025	47
B.	Marrëveshja mes palëve për zhdëmtimet	48
C.	Përcaktimi i shumave dhe kryerja e pagesave	48
VIII.	PËRFUNDIM	49
IX.	VENDIM	49

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) paraqet arsyet për vendimin mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 13 nëntor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") informoi Trupin Gjykues se kishte lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Haxhi Shalën (z. Shala), Sabit Januzin (z. Januzi) dhe Ismet Bahtijarin (z. Bahtijari) (bashkërisht, të akuzuarit) dhe ia paraqiti këto marrëveshje Trupit Gjykues.¹

2. Më 6 dhjetor 2024, në bazë të një vendimi të Trupit Gjykues (Vendimi F00612),² ZPS-ja dorëzoi: (i) versionet e rishikuara të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë të z. Shala (Marrëveshja me z. Shala për Pranimin e Fajësisë), z. Januzi (Marrëveshja me z. Januzi për Pranimin e Fajësisë) dhe z. Bahtijari; (ii) parashtrime në lidhje me këto marrëveshje dhe dënimin;³ dhe (iii) aktakuzën e rishikuar.⁴ Po atë ditë, Mbrojtja e z.

¹ KSC-BC-2023-10, F00596, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim URGJENT nga Prokuroria i Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë*, 13 nëntor 2024, publik, para. 1, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. Versionet e korrigjuara të parashtrimit kryesor dhe shtojcat u dorëzuan më 14 nëntor 2024, F00596/COR, F00596/COR/A01, F00596/COR/A02, F00596/COR/A03.

² KSC-BC-2023-10, F00612, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Çështje të Lidhura me Procedurën e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 20-23, 27, 34(a)-(c), me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 22 janar 2025, [F00612/RED](#).

³ KSC-BC-2023-10, F00618, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime URGJENTE të Prokurorisë në lidhje me Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë dhe Përcaktimin e Dënimit* (Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin), 6 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, publike (ku përfshihen, përkatësisht, [Shala Plea Agreement](#) (Marrëveshja me Shalën për Pranimin e Fajësisë) dhe [Januzi Plea Agreement](#) (Marrëveshja me Januzin për Pranimin e Fajësisë) dhe Shtojcën 3, publike. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 5 shkurt 2025, por u riklasifikua si konfidencial, F00618/RED. Një version i redaktuar publik i ri u dorëzua më 18 shkurt 2025, F00618/RED2.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00619, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim URGJENT i Aktakuzës së Rishikuar*, 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përmban aktakuzën). Versioni i redaktuar publik i aktakuzës u dorëzua më 5 shkurt 2025, F00672/A01.

Shala (Mbrojtja e Shalës),⁵ Mbrojtja e z. Januzi (Mbrojtja e Januzit)⁶ dhe Mbrojtja e z. Bahtijari (Mbrojtja e Bahtijarit)⁷ (së bashku, Mbrojtja), dorëzuan parashtrimet përkatëse të tyre, ku trajtonin aspekte në lidhje me dënimin dhe paraqisnin informacion dhe/ose prova përkatëse.

3. Më 16 dhjetor 2024, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se kishte lidhur një marrëveshje të re për pranimin e fajësisë me z. Bahtijari (Marrëveshja me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë) dhe ia paraqiti marrëveshjen në fjalë Trupit Gjykses.⁸

4. Më 17 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të redaktuar më tej (Aktakuza e 17 dhjetorit 2024).⁹ Në Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024, ZPS-ja tërhoqi një akuzë të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, që ndëshkohet sipas nenit 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 (KPK) dhe nenit 5(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe elementin e “kërcënimit të rëndë”/“kanosjes serioze” të frikësimit gjatë procedurës penale sipas

⁵ KSC-BC-2023-10, F00616, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime me Shkrim në lidhje me Dënimin*, (Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin), 6 dhjetor 2024, publike, me Shtojcat 1-4, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00617, Mbrojtja e Januzit, *Parashtrime të Januzit në lidhje me Dënimin sipas Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë* (Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin), 6 dhjetor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 20 shkurt 2025, F00617/RED.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00620, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të BAHTIJARIT në lidhje me Dënimin*, (Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin), 6 dhjetor 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 11 dhjetor 2024, F00620/COR. Versioni i redaktuar publik i dokumentit origjinal u dorëzua më 18 dhjetor 2024, [F00620/RED](#).

⁸ KSC-BC-2023-10, F00628, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Përbashkët URGJENT i Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë*, 16 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, publike (që përmban [Bahtijari Plea Agreement](#)).

⁹ KSC-BC-2023-10, F00630, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar më Tej*, 17 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i aktakuzës u dorëzua më 5 shkurt 2025, F00672/A02.

nenit 387 të KPK-së.¹⁰ Po atë ditë, ZPS-ja dorëzoi parashtrime shitesë në lidhje me dënimin.¹¹

5. Më 18 dhe 19 dhjetor 2024, Trupi Gjykses mbajti seanca mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë për secilin të akuzuar (seancat për pranimin e fajësisë).¹² Gjatë seancave për pranimin e fajësisë, të akuzuarit u vetëdeklaruan fajtorë për një akuzë të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit, dhe për një akuzë të frikësimit gjatë procedurës penale, sipas nenit 387 të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit.¹³

6. Më 23 dhe 24 janar 2025, në përputhje me urdhrin e 16 janarit 2025,¹⁴ palët dorëzuan parashtrime në lidhje me provat e konsideruara prej tyre si relevante për vlerësimin prej Trupit Gjykses të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në rregullën 94(5)(e) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).¹⁵

¹⁰ *Shih* Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024, para. 30. Më konkretisht, kjo lidhet me Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës së 10 korrikut 2024 (*shih* KSC-BC-2023-10, F00379/A03, Prokurorja e Specializuar, [Public redacted version of 'Confirmed Amended Indictment'](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar) 10 korrik 2024, publik, para. 6, 10, 20, 22-23, 33).

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00629, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Informacionit Shtesë për Përcaktimin e Dënimit* (Parashtrimet Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin), 17 shkurt 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 19 shkurt 2025, F00629/RED.

¹² Transkripti i seancës, 18 dhjetor 2024, publik, f. 378-532 (transkripti i 18 dhjetorit 2024); transkripti i seancës, 19 dhjetor 2024, publik, f. 533-604 (transkripti i 19 dhjetorit 2024).

¹³ **Z. Shala:** transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 430, rreshti 23 deri në f. 432, rreshti 18; **z. Januzi:** transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 483, rreshti 3 deri në f. 484, rreshti 8; **z. Bahtijari:** transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 560, rreshti 19 deri në f. 562, rreshti 13.

¹⁴ KSC-BC-2023-10, F00642, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Dorëzimin e Materialit Provues* (Urdhri i 16 Janarit 2025), 16 janar 2025, publik.

¹⁵ KSC-BC-2023-10, F00651, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në pajtim me Urdhrin F00642* (Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Provat), 23 janar 2025, publike; F00654, Mbrojtja e Januzit, *Përgjigje e Januzit ndaj Urdhrit F00642* (Parashtrimet e Januzit në lidhje me Provat), 23 janar 2025,

7. Më 29 janar 2025, në bazë të urdhrit gojor të 18 dhjetorit 2024,¹⁶ dhe pas dorëzimit të një raporti nga Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave¹⁷ dhe parashtrimeve të palëve,¹⁸ Trupi Gjykses vendosi: (i) të pranonte si viktimë pjesëmarrëse në proces një parashtrues kërkesë (*d.m.th.* V01/10-ën) dhe u kërkoi palëve të dorëzonin versionet e rishikuara të marrëveshjeve të tyre përkatëse për pranimin e fajësisë me propozimet për zhdëmtimet që duhej t'i akordoheshin viktimës në këtë çështje; dhe (ii) të caktonte një seancë për datën 4 shkurt 2025 për marrjen e vendimit në lidhje me Marrëveshjen me Shalën për Pranimin e Fajësisë, Marrëveshjen me Januzin për Pranimin e Fajësisë dhe Marrëveshjen me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë (Vendimi i 29 Janarit 2025).¹⁹

8. Më 3 shkurt 2025, në përputhje me Vendimin e 29 Janarit 2025, palët dorëzuan parashtrime të përbashkëta për zhdëmtimet dhe, konkretisht, u pajtuan që të akuzuarit t'i paguanin bashkërisht 500 euro si shumë zhdëmtimi V01/10-ës, si pjesë e Marrëveshjes me Shalën për Pranimin e Fajësisë, Marrëveshjes me Januzin për

publike; F00657, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Bahtijarit në pajtim me Urdhrin F00642* (Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Provat), 24 janar 2025, publike; F00659, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime të Haxhi Shalës në lidhje me Materialin Provues* (Parashtrimet e Shalës në lidhje me Provat), 24 janar 2025, publike.

¹⁶ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 398, rreshti 1 deri në f. 400, rreshti 5.

¹⁷ KSC-BC-2023-10, F00647, Administratorja, *Raport i Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 20 janar 2025, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial i parashtrimit kryesor u dorëzua po atë ditë, F00647/CONF/RED. Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 30 janar 2025, F00647/CONF/RED2.

¹⁸ KSC-BC-2023-10, F00658, Mbrojtja e Bahtijarit, *PËRGJIGJE E BAHTIJARIT NDAJ KËRKESËS PËR ZHDËMTIM*, 24 janar 2025, konfidenciale; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 shkurt 2025, F00658/RED; F00661, Mbrojtja e Januzit, *Përgjigje e Januzit ndaj Raportit F00647/CONF/RED*, 26 janar 2025, konfidenciale; F00662, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Raportit në lidhje me Kërkesat e Viktimave*, 27 janar 2025, konfidenciale; F00663, Mbrojtja e Shalës, *Përgjigje e Haxhi Shalës ndaj Raportit të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 27 janar 2025, konfidenciale.

¹⁹ KSC-BC-2023-10, F00667, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, Caktimin e Seancës lidhur me Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë dhe Çështje të lidhura me To*, 29 janar 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 31 janar 2025, [F00667/RED](#).

Pranimin e Fajësisë dhe Marrëveshjes me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë (së bashku, Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë).²⁰

9. Më 4 shkurt 2025, gjatë një seance, Trupi Gjykses: (i) miratoi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë; (ii) shpalli të akuzuarit fajtorë sipas Pikës 1 (pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare – me anë të veprimit të përbashkët të një grupi) dhe Pikës 2 (frikësim gjatë procedurës penale) të Aktakuzës së 17 dhjetorit 2024; (iii) e dënoi z. Shala me tre vjet burgim dhe z. Januzi dhe z. Bahtijari me nga dy vjet burgim secili; (iv) urdhëroi të akuzuarit që, brenda datës 19 shkurt 2025, t'i paguanin bashkërisht 500 euro V01/10-ës si shumë zhdëmtimi; dhe (v) bëri të ditur se do të paraqiste më vonë me shkrim arsyet për miratimin e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë, në përputhje me rregullën 94(8) të Rregullores.²¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Trupi Gjykses bazohet mbi nenet 21, 22, 34, 40(2) dhe 44(4)-(5) të Ligjit dhe rregullave 23(8) 94, 163(1)-(4) dhe 6 të Rregullores, dhe, përmes neneve 6(2), 15(2), 16(3) dhe 64 të Ligjit, nenet 17, 21, 31, 387 dhe 401 të KPK-së.²²

²⁰ KSC-BC-2023-10, F00669, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në pajtim me Vendimin F00667* (Parashtrimet e Palëve në lidhje me Zhdëmtimet), 3 shkurt 2025, publike, me Shtojcën 1 (Shtojca e Parashtrimeve të Palëve në lidhje me Zhdëmtimet), publike.

²¹ Transkripti i seancës, 4 shkurt 2025, publik, f. 612, rreshti 19 deri në f. 618, rreshti 23 (transkripti i 4 shkurtit 2025).

²² Trupi Gjykses vë në dukje se neni 15(2) i Ligjit i referohet Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, Kodi nr. 04/L-082 (KPK-ja e vitit 2012), i cili megjithatë u zëvendësua në vitin 2019 me KPK-në. Në KPK dispozitave të cilave u referohet neni 15(2) i Ligjit iu ndërrua numërtimi, përfshirë dispozitat mbi bazën e të cilave janë ngritur akuzat ndaj të akuzuarve në këtë çështje. Kujtojmë se kur zëvendësohen dispozita të veçanta të KPK-së të vitit 2012, të përcaktuara në nenet 15 dhe 16 të Ligjit, në bazë të nenit 64 të Ligjit, ky i fundit duhet të interpretohet se nënkupton dispozitat analoge të legjislacionit pasardhës. Në këtë rast, veprat penale të përcaktuara në nenet 387 dhe 401 të KPK-së janë analoge me veprat penale përkatëse sipas neneve 395 dhe 409 të KPK-së së vitit 2012. *Shih* KSC-BC-2020-07, F00147/RED,

III. ÇËSHITJA PARAPRAKE

11. Trupi Gjykses rikujton se, në Vendimin F00612 të tij, ai përcaktoi dispozitat ligjore të zbatueshme në këtë proces gjyqësor në bazë të rregullës 94 të Rregullores,²³ çka ZPS-ja kërkoi ta kundërshtonte.²⁴ Gjithashtu kujtojmë se, pas një kohe, ZPS-ja e tërhoqi kundërshtimin e saj (Njoftimi për Tërheqje),²⁵ duke vënë megjithatë në dukje se ka një interpretim të ndryshëm nga ai i Trupit Gjykses në lidhje me dispozitat ligjore dhe theksuar se fushëveprimi i çfarëdolloj të drejte për apelim mund të shqyrtohet pas lëshimit të vendimit aktual prej Trupit Gjykses.²⁶

12. Trupi Gjykses konstaton se qëndrimi i lartpërmendur i ZPS-së duket se lë të kuptohet se vendimi F00612, në veçanti konstatimi se “rregulla 94 e Rregullores

Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Defence Preliminary Motions](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes), 8 mars 2021, publik, para. 28-34; F00057, Gjykatësi i Vetëm, [Decision on Defence Challenges](#) (Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes), 27 tetor 2020, publik, para. 24. Trupi Gjykses gjithashtu kujton se ka juridiksion mbi veprat penale kundër administrimit të drejtësisë, sikurse konfirmohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. *Shih* KSC-BC-2023-11, F00005, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* (Vendimi i Konfirmimit në Çështjen 11), 4 dhjetor 2023, konfidencial, para. 14-16, 22 dhe referencat e tjera në të; versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 30 janar 2024, [F00005/RED](#); KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* (Vendimi i Konfirmimit në Çështjen 10), 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 14-16, 22 dhe referencat e tjera në të; version i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i Vendimit të Konfirmimit në Çështjen 10 u lëshuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe F00008/RED; versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të Vendimit të Konfirmimit në Çështjen 10 u dorëzua më 12 tetor 2023, F00008/RED/COR; versioni me më pak redaktime i versionit të korrigjuar të versionit të redaktuar publik të Vendimit të Konfirmimit në Çështjen 10 u lëshua më 3 shtator 2024, [F00008/RED2/COR](#).

²³ *Shih* Vendimin F00612, para. 13-18.

²⁴ KSC-BC-2023-10, F00621, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Rishikim dhe/ose Leje për Apelim të Vendimit F00612*, 9 dhjetor 2024, publike.

²⁵ KSC-BC-2023-10, F00631, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Tërheqjen e Kërkesës F00621*, 17 dhjetor 2024, publik.

²⁶ Njoftimi për Tërheqje, para. 2.

përrjashton të akuzuarin dhe ZPS-në nga apelimi i vendimit të Trupit Gjykses sipas neneve 46-47 të Ligjit”,²⁷ nuk është detyrues. Sidoqoftë, Trupi Gjykses u kujton palëve se vendimet gjyqësore të lëshuara prej paneleve të shkallës së parë janë detyruese për to, përveç nëse këto vendime ndryshohen ose anulohen nga një panel i Gjykatës së Apelit.²⁸ Palët nuk mund të tërheqin apelin në një mënyrë që në thelb shpërfill vendimin e panelit ose një pjesë të tij, duke sugjeruar se mund të vazhdohet ende me të në kundërshtim me vendimin e Trupit Gjykses. Rrjedhimisht, qëndrimi i ZPS-së në Njoftimin për Tërheqje bie ndesh me funksionimin e drejtë të Dhomave të Specializuara (DHS), dhe, më përgjithësisht, me administrimin e duhur të drejtësisë.

IV. E KALUARA E TË AKUZUARVE

13. Z. Shala u lind më 17 mars 1970, në Banjë, Malishevë, Republika e Kosovës (Kosovë). Ai është ushtarak dhe punon edhe si avokat.²⁹ Z. Shala ishte komandanti i z. Bahtijari dhe z. Januzi në Brigadën 121 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë luftës midis UÇK-së dhe forcave serbe në vitet 1998-1999 (lufta e viteve 1998-1999).³⁰

²⁷ Vendimi F00612, para. 18.

²⁸ *Për ngjashmëri*, ICC, *Situation in the Islamic Republic of Afghanistan*, ICC-02/17-216, Appeals Chamber, [Decision on Prosecutor's notice of discontinuance of the appeal](#), 16 March 2023, para. 37.

²⁹ KSC-BC-2023-11, Transkripti i seancës, 13 dhjetor 2023, f. 3, rreshtat 10-20; 082195-082199, f. 082197; 124051-124112-ET, f. 124052.

³⁰ 116063-TR-ET Pjesa 1, f. 9-10; 116065-TR-ET Pjesa 1 RED2, f. 7-9; 083076-083076-ET Rishikuar; *shih*, për shembull, KSC-BC-2020-05, F00494/RED3/COR, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit*, 16 dhjetor 2022, publik, para. 701, 710; KSC-BC-2020-04, F00847/RED, Trupi Gjykses I, [Public redacted version of Trial Judgment and Sentence](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit dhe Dënimit) (Aktgjykimi *Shala*), 16 korrik 2024, publik, para. 919-921, me Shtojcën 1, konfidenciale.

14. Z. Januzi u lind më 29 prill 1966 në Fushticë të Epërme, Kosovë dhe është në pension.³¹ Ai iu bashkua UÇK-së dhe shërbeu në Brigadën 121 nga qershori 1998 deri në fund të luftës së viteve 1998-1999.³² [REDAKTUAR].³³

15. Z. Bahtijari, i njohur edhe si "Shema", u lind më 27 shkurt 1963 në Fushticë të Poshtme, Kosovë. Ai është ndërtues dhe elektrikist.³⁴ Ai iu bashkua UÇK-së dhe shërbeu në Brigadën 121 nga maji 1998 deri në fund të luftës së viteve 1998-1999.³⁵ [REDAKTUAR].³⁶

V. KRITERET E RREGULLËS 94(2) DHE (5)

16. Për të miratuar Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë, Trupi Gjykues duhet të bindet se janë përmbushur kriteret e rregullës 94(2) dhe (5) të Rregullores.

A. RREGULLA 94(2)

17. Pasi shqyrtoi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë, Trupi Gjykues është bindur se, siç përcaktohet në rregullën 94(2) të Rregullores, secila prej tyre përmban një marrëveshje midis ZPS-së dhe Mbrojtjes mbi: (i) akuzat, që përfshijnë pjesëmarrjen e të akuzuarit në veprat penale për të cilat janë ngritur akuzat dhe format e përgjegjësisë

³¹ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, f. 19, rreshti 10 deri në f. 20, rreshti 5; 116063-TR-ET Pjesa 1 RED, f. 4, rreshti 8, f. 9, rreshtat 3-6, 12-17.

³² 116063-TR-ET Pjesa 1, f. 9, rreshti 20 deri në f. 10, rreshti 19.

³³ [REDAKTUAR].

³⁴ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, f. 4, rreshtat 6-15; 116065-TR-ET Pjesa 1 RED2, f. 5, rreshtat 17-25, f. 6, rreshtat 6-13, 18-19.

³⁵ 116065-TR-ET Pjesa 1 RED2, f. 7, rreshti 2 deri në f. 8, rreshti 9.

³⁶ [REDAKTUAR].

penale; (ii) dënimin konkret ose shkallëzimin e dënimit; dhe (iii) zhdëmtimet për viktimën pjesëmarrëse në proces.

B. RREGULLA 94(5)(A)-(D) DHE (F)

18. Sa u përket kriterëve të rregullës 94(5)(a)-(d) të Rregullores, Trupi Gjykses vëren se secili prej të akuzuarve ka konfirmuar me shkrim dhe me gojë se: (a) mbrojtësit përkatës të tyre kanë diskutuar me ta kushtet e marrëveshjeve të tyre përkatëse për pranimin e fajësisë;³⁷ (b) të akuzuarit i kuptojnë kushtet e marrëveshjeve të tyre përkatëse për pranimin e fajësisë;³⁸ (c) të akuzuarit pranojnë faktet në lidhje me akuzat e përfshira në marrëveshjet e tyre përkatëse për pranimin e fajësisë dhe pajtohen me vullnet të lirë më këto marrëveshje, pa kërcënime ose detyrim;³⁹ dhe (d) të akuzuarit kuptojnë pasojat e marrëveshjeve të tyre përkatëse për pranimin e fajësisë dhe heqin dorë nga e drejta për t'u gjykuar me procedurë gjyqësore të zakonshme.⁴⁰

³⁷ **Z. Shala:** Marrëveshja me Shalën për Pranimin e Fajësisë, para. 6, 19, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 409, rreshti 21 deri në f. 410, rreshti 4; *shih gjithashtu* transkriptin e 18 dhjetorit 2024, f. 429, rreshti 23 deri në f. 430, rreshti 6; Parashtrimet e Palëve në lidhje me Zhdëmtimet, para. 1; **Z. Januzi:** Marrëveshja me Januzin për Pranimin e Fajësisë, para. 6, 19, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 466, rreshtat 15-21; Parashtrimet e Palëve në lidhje me Zhdëmtimet, para. 1; **Z. Bahtijari:** Marrëveshja me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë, para. 6, 19, 24; transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 541, rreshti 21 deri në f. 542, rreshti 1; Parashtrimet e Palëve në lidhje me Zhdëmtimet, para. 1.

³⁸ **Z. Shala:** Marrëveshja me Shalën për Pranimin e Fajësisë, para. 1, 6-10, 12, 13, 17-22, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 410, rreshtat 17-22; **Z. Januzi:** Marrëveshja me Januzin për Pranimin e Fajësisë, para. 1, 6-10, 12, 13, 17-22, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 467, rreshtat 3-12; **Z. Bahtijari:** Marrëveshja me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë, para. 1, 6-10, 12, 13, 17-22, 24; transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 542, rreshti 11 deri në f. 543, rreshti 1.

³⁹ **Z. Shala:** Marrëveshja me Shalën për Pranimin e Fajësisë, para. 5-8, 19, 24 dhe Shtojca 1; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 410, rreshti 23 deri në f. 424, rreshti 23; **Z. Januzi:** Marrëveshja me Januzin për Pranimin e Fajësisë, para. 5-8, 19, 24 dhe Shtojca 1; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 467, rreshti 13 deri në f. 479, rreshti 20; **Z. Bahtijari:** Marrëveshja me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë, para. 5-8, 19, 24 dhe Shtojca 1; transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 543, rreshti 2 deri në f. 557, rreshti 22.

⁴⁰ **Z. Shala:** Marrëveshja me Shalën për Pranimin e Fajësisë, para. 12-13, 17-18, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 424, rreshti 25 deri në f. 430, rreshti 22; **Z. Januzi:** Marrëveshja me Januzin për

19. Lidhur me kriterin e rregullës 94(5)(f) të Rregullores, Trupi Gjykues fillimisht vëren se marrëveshjet për pranimin e fajësisë, të cilat janë një formë e drejtësisë së negociuar që përdoret në drejtësinë penale ndërkombëtare,⁴¹ mund t'i sjellin një sërë dobish DHS-së, pasi pranimi i përgjegjësisë nga i akuzuari përmes lidhjes së një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë, mund të sjellë në njëfarë mase lehtësim shpirtëror dhe njohje të dëmit për viktimat, të përmbyllë dhe t'i japë qartësi procesit dhe të çojë në një zgjidhje më të shpejtë të çështjes, duke kursyer për rrjedhojë kohë dhe kapacitete të vlefshme. Gjithashtu, lidhja e një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë zvogëlon ose eliminon nevojën që dëshmitarët dhe viktimat të japin dëshmi, dhe në të njëjtën kohë, i mundëson të akuzuarit të marrë përgjegjësi për veprimet e tij. Në këtë kuptim, marrëveshjet për pranimin e fajësisë u shërbejnë pikësynimeve më të gjera të drejtësisë, duke mundësuar llogaridhënie dhe kontribuar në përcaktimin e të vërtetës, si dhe duke optimizuar në të njëjtën kohë kapacitetet gjyqësore.

20. Në çështjen aktuale, Trupi Gjykues vëren, nga njëra anë, se ZPS-ja u pajtua me Mbrojtjen për të tërhequr nga aktakuza e 10 korrikut 2024 akuzën e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë, që

Pranimin e Fajësisë, para. 12-13, 17-18, 24; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 479, rreshti 22 deri në f. 483, rreshti 2; **Z. Bahtijari**: Marrëveshja me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë, para. 12-13, 17-18, 24; transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 557, rreshti 24, deri në f. 560, rreshti 17.

⁴¹ Marrëveshjet për pranimin e fajësisë janë përdorur në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën (*shih* rregullën 62^{ter} të [Rules of Procedure and Evidence of the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia](#) (Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe rregullën 62^{bis} të [Rules of Procedure and Evidence of the International Criminal Tribunal for Rwanda](#) (Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën). Neni 65 i [Rome Statute of the International Criminal Court](#) (Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare) përcakton procedurat për pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohet personi i akuzuar. Në paragrafin 5 të nenit të lartpërmendur pranohet mundësia e “diskutimeve midis Prokurorit dhe Mbrojtjes”. Sidoqoftë, këto nuk janë detyruese për Gjykatën.

ndëshkohet sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit dhe elementin e kërcënimit të rëndë të frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së.⁴² Gjithashtu, Trupi Gjykses i kushton vëmendje faktit se Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë u dorëzuan pak para hapjes së gjykimit. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses gjykon se: (i) dëshmitarët kanë mbështetur plotësisht zgjidhjen e çështjes me anë të Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë dhe janë shprehur se ndjehen të lehtësuar pasi nuk janë më të detyruar të dëshmojnë, një faktor ky të cilit Trupi Gjykses i jep shumë peshë;⁴³ (ii) pranimi prej të akuzuarve i veprimeve kriminale të tyre dhe pajtimi i tyre për të paguar zhdëmtime, ndonëse simbolike, ofron lehtësim shpirtëror dhe njohje të dëmit për V01/10-ën; (iii) pranimi i fajësisë prej të akuzuarve kontribuon në përcaktimin e të vërtetës në lidhje me disa nga ngjarjet që lidhen me kontaktimin e [REDAKTUAR] (dëshmitari 1) (përkatesisht, kontakti i parë dhe kontakti i dytë dhe së bashku, kontaktet) në datat 5 dhe 12 prill 2023, dhe konfirmon drejtpërdrejt ekzistencën e atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë ndaj dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHS-së; (iv) në qoftë se do të mbahej gjykim, vëmendja dhe trajtimi i shtuar në shtyp dhe media mund të përkeqësonte më tej rreziqet për sigurinë e dëshmitarëve dhe mund të sillte zbatimin e masave mbrojtëse shtesë – një kriter ky që është i papërdorshëm në këtë rast;⁴⁴ (v) zgjidhja e çështjes para nisjes së gjykimit kursen kapacitete të konsiderueshme të DHS-së/ZPS-së, që mund t’u kushtohen hetimeve dhe/ose ndjekjeve penale të tjera; dhe (vi) lidhja e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë mund të inkurajojë kryes të tjerë që të paraqiten dhe të pranojnë krimet e tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është

⁴² *Shih më lart* poshtëshënimin 10.

⁴³ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 17; KSC-BC-2023-10, F00603/A01, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 1 e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës F00599* (Shtojca e Përgjigjes F00603), 15 nëntor 2024, konfidenciale dhe *ex parte*, para. 2-3.

⁴⁴ Shtojca e Përgjigjes F00603, para. 1.

bindur se interesat e drejtësisë janë marrë parasysh si duhet, sikurse kërkohet në bazë të rregullës 94(5)(f) të Rregullores.

21. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se janë përmbushur kriteret e rregullës 94(5)(a)-(d) dhe (f) të Rregullores.

C. RREGULLA 94(5)(E)

1. Qasja e Trupit Gjykses

22. Trupi Gjykses vëren se, sipas rregullës 94(5)(e) të Rregullores, për të miratuar Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë, ai duhet të bindet se ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e fakteve thelbësore të nevojshme për vërtetimin e veprave penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit. Trupi Gjykses gjykon se kriteri i lartpërmendur përfshin kryerjen e një vlerësimi faktik, si dhe të një vlerësimi ligjor.

23. Sa i përket materialit provues përkatës në mbështetje të vlerësimit faktik, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e ZPS-së dhe Mbrojtjes së Januzit, sipas të cilave faktet e pranuar nga palët të përshkruara në Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë (faktet e pranuar),⁴⁵ janë të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit të rregullës 94(5)(e) të Rregullores.⁴⁶ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Januzit dhe Mbrojtja e Bahtijarit i referohen faktit se gjatë seancave për pranimin e fajësisë, të akuzuarit konfirmuan pranimin prej tyre të fakteve të pranuar dhe, çka është më e

⁴⁵ *Shih* Marrëveshjen me Shalën për Pranimin e Fajësisë, f. 12 (Shtojca 1); Marrëveshjen me Januzin për Pranimin e Fajësisë, f. 12 (Shtojca 1); Marrëveshjen me Bahtijarin për Pranimin e Fajësisë, f. 12 (Shtojca 1).

⁴⁶ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Provat, para. 2; Parashtrimet e Januzit në lidhje me Provat, para. 3.

rëndësishme, pranuan fajësinë në lidhje me këto fakte.⁴⁷ Mbrojtja e Januzit dhe ZPS-ja gjithashtu argumentojnë se faktet e përfshira në Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë janë konfirmuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake, pas paraqitjes prej ZPS-së të aktakuzës fillestare, së bashku me materialin provues që mbështet pretendimet sipas rregullës 86(3)(a)-(b) të Rregullores (Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)).⁴⁸ ZPS-ja argumenton se, në qoftë se zgjedh të kryejë një vlerësim të tillë, Trupi Gjykses ka para vetes të gjitha provat relevante të nevojshme për t'u bindur se Faktet e Pranuar mbështeten nga prova të pavarura.⁴⁹ Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja e Shalës parashtron se Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë dhe materiali provues i përmendur në përmbledhjen sipas rregullës 86(3), përmbushin kriterin e rregullës 94(5)(e) të Rregullores.⁵⁰

24. Pasi ka shqyrtuar argumentet e palëve, Trupi Gjykses rithekson pikëpamjen e vet se për miratimin e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë, ai duhet të bindet se faktet e pranuar mbështeten gjithashtu nga provat.⁵¹ Për këtë qëllim, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse materiali provues i nxjerrë prej ZPS-së si pjesë e dokumentacionit të kësaj çështjeje (materiali i dokumentacionit të çështjes), mbështet çdo fakt të pranuar.

25. Lidhur me vlerësimin ligjor, Trupi Gjykses duhet të bindet se veprimet e të akuzuarve të përshkruara në faktet e pranuar, përmbushin elementet ligjore të veprave penale sipas neneve 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së, si dhe format përkatëse të përgjegjësisë penale.

⁴⁷ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Provat, para. 4; Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Provat, para. 11. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Provat, para. 3.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Provat, para. 1, 6; Parashtrimet e Januzit në lidhje me Provat, para. 3.

⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Provat, para. 1, 7.

⁵⁰ Parashtrimet e Shalës në lidhje me Provat, para. 8.

⁵¹ Urdhri i 16 Janarit 2025, para. 8-9.

2. Vlerësimi faktik

26. Pasi ka analizuar materialin e dokumentacionit të çështjes, Trupi Gjykses është bindur se faktet e pranuar, të riprodhuara më poshtë në pika kryesore, mbështeten gjithashtu me prova:

Secili i akuzuar pranon se ishte pjesë e një grupi që kërkoi të nxiste dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi para Dhomave të Specializuara të Kosovës, duke i premtuar një përfitim. Konkreisht, z. Januzi dhe z. Bahtijari, duke vepruar sipas udhëzimeve të z. Shala,⁵² kontaktuan dëshmitarin 1 në shtëpinë e tij, përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023.⁵³ Gjatë kontaktit të parë, z. Bahtijari i tha dëshmitarit 1 që të tërhiqte dëshminë para Dhomave të Specializuara të Kosovës.⁵⁴ Gjatë kontaktit të dytë, z. Januzi, në vijim të kontaktit të parë, i bëri dëshmitarit 1 ofertën se z. Shala dhe të tjerë do ta ndihmonin atë në qoftë se tërhiqte dëshminë.⁵⁵ Z. Shala dhe z. Januzi komunikuan dhe

⁵² 112768-112768 RED, f. 112768, para. 2; 112769-112772 RED2, f. 112769-112770, para. 3-5; 112906-TR-AT Pjesa 1 Rishikuar 1-ET RED2, f. 7, rreshtat 17-19; 116599-TR-ET Pjesa 1, f. 9, rreshtat 6-8, 22-23; 120547-01-TR-AT-ET, f. 5, rreshti 7 deri në f. 6, rreshti 2; 117751-TR-ET Pjesa 1 RED, f. 17, rreshti 13; *shih gjithashtu* 117047-TR-ET Pjesa 1 RED2, f. 24, rreshti 20 deri në f. 25, rreshti 11.

⁵³ **Kontakti i parë:** 112768-112768 RED2, f. 1; 112769-112772 RED2, para. 3-8; 112906-TR-AT Pjesa 1 Rishikuar 1-ET RED2, f. 4, rreshti 1 deri në f. 5, rreshti 1; f. 22, rreshti 11 deri në f. 23, rreshti 4; 112909-TR-ET Pjesa 1, f. 4, rreshti 5 deri në f. 6, rreshti 23, f. 8, rreshtat 9-11. **Kontakti i dytë:** 120547-01-TR-AT-ET, f. 3, rreshti 21 deri në f. 10, rreshti 20, f. 22, rreshtat 24-25, f. 26, rreshtat 17-18, f. 28, rreshtat 5-6, 12-19, f. 31, rreshtat 13-17, f. 33, rreshtat 1-12, f. 47, rreshtat 3-15, f. 49, rreshtat 10-12; 112906-TR-AT Pjesa 1 Rishikuar 1-ET RED2, f. 5, rreshti 23 deri në f. 10, rreshti 13; 116599-TR-ET Pjesa 1 RED, f. 14, rreshti 25 deri në f. 15, rreshti 10, f. 16, rreshti 5 deri në f. 17, rreshti 5.

⁵⁴ 112768-112768 RED2, f. 1; 112769-112772 RED2, para. 3-8; 112906-TR-AT Pjesa 1 Rishikuar 1-ET RED2, f. 4, rreshti 1 deri në f. 5, rreshti 1; f. 22, rreshti 11 deri në f. 23, rreshti 4; -TR-ET Pjesa 1, f. 4, rreshti 5 deri në f. 6, rreshti 23, f. 8, rreshtat 9-11.

⁵⁵ *Shih për shembull* 120547-01-TR-AT-ET, f. 3, rreshti 21 deri në f. 10, rreshti 20, f. 22, rreshtat 24-25, f. 26, rreshtat 17-18, f. 28, rreshtat 5-6, 12-19, f. 31, rreshtat 13-17, f. 33, rreshtat 1-12, f. 47, rreshtat 3-15, f. 49,

u koordinuan me njëri-tjetrin për kontaktet e tyre me dëshmitarin 1, para dhe pas secilit prej kontakteve.⁵⁶ Z. Bahtijari komunikoi dhe u koordinua me z. Shala dhe z. Januzi për kontaktet me dëshmitarin 1, para dhe pas kontaktit të parë dhe para kontaktit të dytë.⁵⁷

3. Vlerësimi ligjor

a) Frikësim gjatë procedurës penale (Pika 2)⁵⁸

i. Dispozitat ligjore përkatëse

27. Në nenin 387 të KPK-së përcaktohet se kushdo që përdor forcë apo kërcënim të rëndë, apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtion dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose për të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjykatësit, kur informacione të tilla ndërliken me

rreshtat 10-12; 112906-TR-AT Pjesa 1 Rishikuar 1-ET RED2, f. 5 rreshti 23 deri në f. 10, rreshti 13; 116599-TR-ET Pjesa 1 RED, f. 14, rreshti 25 deri në f. 15, rreshti 10, f. 16, rreshti 5 deri në f. 17, rreshti 5.

⁵⁶ *Shih për shembull*, të dhënat e thirrjeve telefonike nga telefoni mobil i z. Januzi, SPOE00339028-00339032 RED, f. SPOE00339029-SPOE00339032; të dhënat e thirrjeve telefonike nga telefoni mobil i z. Shala, SPOE00339009-00339013 RED, f. SPOE00339010-SPOE00339013; incizimin, 120547-01-TR-AT-ET, f. 5, rreshti 6 deri në f. 10, rreshti 20, f. 27, rreshtat 3-15, f. 28, rreshtat 5-6, f. 47, rreshti 20 deri në f. 48, rreshti 1.

⁵⁷ *Shih për shembull*, të dhënat e thirrjeve telefonike nga telefoni mobil i z. Bahtijari, SPOE00339014-00339017 RED, f. SPOE00339015-SPOE00339017; të dhënat e thirrjeve telefonike nga telefoni mobil i z. Januzi, SPOE00339033-00339038 RED, f. SPOE00339035-SPOE00339038; incizimin, 120547-01-TR-AT-ET, f. 3, rreshtat 21-22, f. 4, rreshti deri në f. 5, rreshti 7, f. 6, rreshtat 21-22, 24-25, f. 28, rreshtat 5-6.

⁵⁸ Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme ta fillojë vlerësimin ligjor me Pikën 2, meqenëse, sipas tij, faktet që mbështesin veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale përbëjnë pikëfillësën e veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Pikës 1.

pengimin e procedurës, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.⁵⁹

28. Bashkëkryerja, sipas nenit 31 të KPK-së, kërkon që (i) dy apo më shumë persona së bashku (ii) të marrin pjesë në kryerjen e veprës penale ose të kontribuojnë thelbësisht në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e veprës penale.⁶⁰ Sa i përket elementit mendor, për këtë formë të përgjegjësisë penale nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, sipas nenit 21 të KPK-së.⁶¹

ii. Analizë

29. *Vepra penale: elementet materiale dhe mendore.* Trupi Gjykses konstaton se oferta për “ndihmë” e bërë nga z. Januzi për dëshmitarin 1 gjatë kontaktit të dytë –siç përshkruhet në faktet e pranuar – përfaqëson një “deklaratë ose premtim” për dëshmitarin 1, ku “deklarohet zotimi” se z. Shala dhe persona të tjerë do ta “ndihmonin” dëshmitarin 1, në qoftë se ai tërhiqte dëshminë e tij para DHS-së.⁶² Trupi

⁵⁹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 26 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve materiale dhe mendore të veprës penale, *shih* paragrafët 27-35 dhe referencat e tjera në to. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 26 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve materiale dhe mendore të veprës penale, *shih* paragrafët 27-28, 30, 32-35 dhe referencat e tjera në to.

⁶⁰ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 58 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve të formës së përgjegjësisë penale, *shih* paragrafët 59-60 dhe referencat e tjera në to. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 58 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve të formës së përgjegjësisë penale, *shih* paragrafët 59-60 dhe referencat e tjera në to.

⁶¹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 56 (dhe referencat e tjera në të); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 56 (dhe referencat e tjera në të).

⁶² *Shih më lart* paragrafin 26. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2023-10, F00377, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë dhe Aspektet Përkatëse* (Vendimi për Ndryshimet në Çështjen 10), 8 korrik 2024, konfidencial, para. 34 (dhe referencat në të), 53; versioni i redaktuar publik u lëshua më 9 korrik 2024, [F00377/RED](#); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 29 (dhe referencat në të), 95.

Gjykues gjithashtu konstaton se veprimet dhe deklaratat e lartpërmendura të z. Januzi tregojnë qartë një ofertë me një lloj forme përfitimi, si p.sh. një përfitim, fitim, ose të mirë materiale.⁶³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se veprimet dhe deklaratat e z. Januzi gjatë kontaktit të dytë përbëjnë “premtim për dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër”, sipas nenit 387 të KPK-së..

30. Duke marrë parasysh se, sipas fakteve të pranuara, oferta për ndihmë u bë në shkëmbim të tërheqjes prej dëshmitarit 1 të dëshmisë së tij para DHS-së, Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se: (i) dëshmitari 1 është një person që ka dhënë ose ka të ngjarë të japë dëshmi para DHS-së/ZPS-së;⁶⁴ dhe (ii) qëllimi i ofertës për ndihmë ishte të nxitej dëshmitari 1 që të mos jepte dëshmi në një proces gjyqësor zyrtar të DHS-së (procesi i DHS-së), sipas nenit 387 të KPK-së.⁶⁵

31. Trupi Gjykues konstaton se z. Januzi kishte dijeni dhe veproi me dëshirën për të përdorur premtimin për përfitim, në mënyrë që dëshmitari 1 të nxitej që të mos jepte dëshmi për DHS-në/ZPS-në në kuadër të procesit të DHS-së dhe, rrjedhimisht, ai veproi me synim të drejtpërdrejtë sipas kuptimit të nenit 21 të KPK-së.⁶⁶

32. *Forma e përgjegjësisë penale: bashkëkryerje.* Trupi Gjykues konstaton se, siç përcaktohet në faktet e pranuara, z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari vepruan në mënyrë të koordinuar, duke marrë pjesë ose kontribuar në masë të konsiderueshme në kryerjen e veprës penale të paraqitur në Pikën 2, duke pasur parasysh se: (i) kontakti

⁶³ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin për Ndryshimet në Çështjen 10, para. 34 (dhe referencat në të), 53; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 29 (dhe referencat në të), 95.

⁶⁴ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 30 (dhe referencat në të), 73, 85, 94; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 30 (dhe referencat në të), 74. [REDAKTUAR].

⁶⁵ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 93, 95; Vendimin për Ndryshimet në Çështjen 10, para. 53.

⁶⁶ *Shih gjithashtu* Vendimin për Ndryshimet në Çështjen 10, para. 56; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 32-33, dhe referencat e tjera në të; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 32-33 dhe referencat e tjera në të.

i parë dhe kontakti i dytë u kryen me qëllim që dëshmitari 1 të nxitej që të mos jepte dëshmi në DHS; (ii) të akuzuarit ndanë detyrat midis tyre; (iii) z. Januzi dhe z. Bahtijari vepruan nën drejtimin e z. Shala, përmes marrjes së udhëzimeve prej z. Shala dhe i raportuan atij mbi rezultatin e kontakteve në fjalë; (iv) kontakti i dytë u krye si vazhdim i domosdoshëm i kontaktit të parë; dhe (v) të akuzuarit komunikuan dhe u koordinuan me njëri-tjetrin për kontaktet me dëshmitarin 1, para dhe pas kontaktit të parë dhe kontaktit të dytë.⁶⁷

33. Lidhur me elementin mendor të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykues konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve u bënë me synim të drejtpërdrejtë.⁶⁸

34. *Përfundim.* Trupi Gjykues është bindur se: (i) veprimet dhe deklaratat e z. Januzi përmbushin elementet e veprës penale të frikësimit gjatë procedurës penale; dhe (ii) sjellja e të akuzuarve përmbush elementet e formës së përgjegjësisë penale të bashkëkryerjes. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vepra penale sipas nenit 387 të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit, e përfshirë në Pikën 2 të Aktakuzës së 17 dhjetorit 2024, u krye bashkërisht dhe qëllimisht nga të akuzuarit, sipas neneve 21 dhe 31 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

b) Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1)

i. Dispozitat ligjore përkatëse

⁶⁷ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 134; Vendimin për Ndryshimet në Aktakuzën e Çështjes 10, para. 62.

⁶⁸ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 136; Vendimin për Ndryshimet në Çështjen 10, para. 63.

35. Në nenin 401(2) të KPK-së përcaktohet se kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.⁶⁹

36. Në nenin 401(5) të KPK-së përcaktohet se “nëse vepra penale [nga paragrafi 2 i këtij neni] kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.”⁷⁰

37. Kryerja, sipas nenit 17(1) të KPK-së, kërkon që kryesi të kryejë fizikisht elementet objektive të veprës penale, ose të mos veprojë kur sipas ligjit i kërkohet të veprojë.⁷¹ Sa i përket elementit mendor, për këtë formë të përgjegjësisë penale nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, sipas nenit 21 të KPK-së.⁷²

ii. Analizë

⁶⁹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 47 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve të veprës penale, *shih* paragrafët 42, 48-52 dhe referencat e tjera në të. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 47 dhe referencat e tjera në të. Për një shpjegim të mëtejshëm të elementeve të veprës penale, *shih* paragrafët 42, 48-52 dhe referencat e tjera në të.

⁷⁰ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 37, *shih gjithashtu* paragrafin 41 (dhe referencat e tjera në të); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 37, *shih gjithashtu* paragrafin 41 (dhe referencat e tjera në të).

⁷¹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 56-57 (dhe referencat e tjera në të); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen, para. 56-57 (dhe referencat e tjera në të).

⁷² *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 56 (dhe referencat e tjera në të); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 56 (dhe referencat e tjera në të).

38. *Vepra penale: elementet materiale dhe mendore.* Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit formuan një “grup” të përbërë nga së paku tre persona, siç parashikohet në nenin 113(12) të KPK-së.⁷³

39. *“Veprim i përbashkët”.* Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se secili i akuzuar kontribuoi në veprimin e përbashkët ose mundësoi në ndonjë formë tjetër “veprimin e përbashkët” sipas nenit 401(2) të KPK-së,⁷⁴ duke marrë parasysh se: (i) z. Januzi dhe z. Bahtijari kontaktuan dëshmitarin 1 në shtëpinë e tij përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023, sipas udhëzimeve të z. Shala; (ii) gjatë kontaktit të parë, z. Bahtijari i tha dëshmitarit 1 se ai duhej të tërhiqte dëshminë e tij në DHS; (iii) gjatë kontaktit të dytë, z. Januzi, në vijim të kontaktit të parë, i bëri dëshmitarit 1 ofertën se z. Shala dhe të tjerët do ta ndihmonin atë në qoftë se ai tërhiqte dëshminë e tij në DHS; (iv) kontakti i parë dhe kontakti i dytë u kryen me qëllim që dëshmitari 1 të nxitej që të mos jepte dëshmi në DHS; dhe (v) të akuzuarit komunikuan dhe u koordinuan me njëri-tjetrin për kontaktet me dëshmitarin 1, para dhe pas kontaktit të parë dhe kontaktit të dytë.⁷⁵

40. *“Pengon”.* Trupi Gjykses është i mendimit se sjellja e të akuzuarve, e përshkruar më lart, në parim mund të pengojë, vështirësojë dhe/ose vonojë punën e prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së, si dhe të punonjësve të DHS-së, në kuadër të proceseve të DHS-së,⁷⁶ në qoftë se oferta për “ndihmë” do të krijonte një efekt të fortë shkurajues te dëshmitari 1 për të mos dëshmuar në procesin e DHS-së dhe, si rezultat, dëshmitari 1 do të vendoste të ndërpriste bashkëpunimin me ZPS-në/DHS-në dhe do të refuzonte

⁷³ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 49 (dhe referencat e tjera në të), 119, 124; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 49 (dhe referencat e tjera në të), 113, 124.

⁷⁴ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 49 (dhe referencat e tjera në të), 124; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 49 (dhe referencat e tjera në të), 124.

⁷⁵ *Shih më lart* para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 119-124; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 113-118.

⁷⁶ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 41-42 (dhe referencat e tjera në të); Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 41-42 (dhe referencat e tjera në të).

të jepte dëshmi në procesin e DHS-së. Megjithatë, në rastin konkret, faktet e pranuarra: (i) [REDAKTUAR]; (ii) nuk tregojnë se pati ndonjë pengesë konkrete dhe reale në hetimet e ZPS-së që mund t'i atribuohet sjelljes së të akuzuarve, apo se veprimet e tyre ndikuan negativisht në kryerjen e procesit të DHS-së; (iii) nuk tregojnë se pati ndonjë veprim, kryerja e të cilit prej DHS-së/ZPS-së si pjesë e punës së tyre në kuadër të proceseve të DHS-së, u pengua, u vështirësua ose u vonua; ose (iv) nuk demonstrojnë se, si rezultat i shpenzimeve shtesë për hetimin e fakteve të pranuarra në këtë çështje,⁷⁷ ZPS-ja u pengua ose u vonua në kryerjen e funksioneve të zakonshme hetimore të saj.⁷⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se faktet e pranuarra nuk vërtetojnë se të akuzuarit penguan persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.⁷⁹

41. Pavarësisht nga sa më sipër, neni 401(2) i KPK-së ndalon gjithashtu dhe *tentativën* për të penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.⁸⁰ Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se të akuzuarit – si grup – morën pjesë në një përpjekje të përbashkët për të nxitur dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi në procesin e DHS-së, gjë që në parim mund të rezultonte në pengimin e punës së prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së, si dhe të punonjësve të DHS-së, në kontekstin e proceseve të DHS-së.⁸¹ Rrjedhimisht, veprimet dhe deklaratat e lartpërmendura të të akuzuarve përmbushin një prej elementeve materiale të kësaj vepre penale, pasi përbëjnë tentativë për

⁷⁷ Shih Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024, para. 18.

⁷⁸ Shih, në mënyrë të ngjashme KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykses II, [Public Redacted Version of the Trial Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), 18 maj 2022, publik, para. 648-649, 651, 653.

⁷⁹ Shih gjithashtu Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 42 (dhe referencat e tjera në të), 110-111, 125; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 42 (dhe referencat e tjera në të) 104-105, 119.

⁸⁰ Shih më lart para. 35 dhe referencat e tjera në të.

⁸¹ Shih më lart para. 38-40.

kryerjen e veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.⁸²

42. *Formë e rëndë.* Trupi Gjykues kujton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbëjnë pengim të punës së prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së, si dhe të punonjësve të DHS-së, në kuadër të proceseve të DHS-së.⁸³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se të akuzuarit kryen vepër penale ndaj një “zyrtari” gjatë kryerjes së “detyrave zyrtare”, sipas nenit 113(2) të KPK-së, dhe, më konkretisht, ndaj gjykatësit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë ose personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria.⁸⁴ Duke pasur këtë parasysh, Trupi Gjykues konstaton se janë përmbushur kriteret e formës së rëndë të veprës penale, të përcaktuara në nenin 401(5) të KPK-së.

43. Trupi Gjykues konstaton se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për të nxitur dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi në procesin e DHS-së, çka rrjedhimisht pengoi punën e zyrtarëve të ZPS-së/DHS-së, në veçanti të prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së, në kuadër të proceseve të DHS-së, dhe se synimi i të akuzuarve ishte të merrnin pjesë në veprimin e përbashkët të një grupi për të arritur qëllimin për të penguar, çka do të thotë se ata vepruan me synim të drejtpërdrejtë sipas kuptimit të nenit 21 të KPK-së.⁸⁵

⁸² *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 126-127, 129; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 120-121, 123.

⁸³ *Shih më lart* para. 40-41.

⁸⁴ *Shih më lart* para. 36 dhe referencat e tjera në të. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 127; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 121.

⁸⁵ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 51-52 (dhe referencat e tjera në të), 128; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 51-52 (dhe referencat e tjera në të), 122.

44. *Forma e përgjegjësisë penale: kryerje.* Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit kryen fizikisht dhe qëllimisht veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.⁸⁶

45. *Përfundim.* Trupi Gjykses është bindur se (i) veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përmbushin elementet e veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare; dhe (ii) ata e kryen veprën penale si kryes të drejtpërdrejtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vepra penale sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit, e përfshirë në Pikën 1 të Aktakuzës së 17 dhjetorit 2024, u krye qëllimisht nga të akuzuarit, sipas neneve 17 dhe 21 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

4. Përfundim

46. Pasi mori parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se, siç përcaktohet në rregullën 94(5)(e) të Rregullores, ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e fakteve thelbësore të nevojshme për vërtetimin e veprave penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarve, sikurse përcaktohet në Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë.

D. PËRFUNDIM NË LIDHJE ME KRITERET E RREGULLËS 94(2) DHE (5)

47. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se janë përmbushur kriteret e rregullës 94(2) dhe (5) dhe pranon vetëdeklarimin e fajësisë të bërë nga të akuzuarit gjatë seancave për pranimin e fajësisë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i shpall të akuzuarit fajtorë për Pikat 1 dhe 2, të përfshira në Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024.

⁸⁶ *Shih më lart* paragrafin 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 11, para. 56-57 (dhe referencat e tjera në të), 132; Vendimin e Konfirmimit në Çështjen 10, para. 56-57 (dhe referencat e tjera në të), 126.

VI. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

48. Pasi ka shpallur fajtorë z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari për Pikat 1 dhe 2 të përfshira në Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024, Trupi Gjykses do të përcaktojë tani dënimin për secilën akuzë.

A. PARASHTRIMET E PALËVE

1. ZPS-ja

49. ZPS-ja parashtron se, për fuqizimin e mandatit të DHS-së dhe ZPS-së për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, Trupi Gjykses duhet të shqiptojë dënime të larta me burgim ndaj të akuzuarve, që pasqyrojnë, ndër të tjera, peshën e veprave penale, rolet dhe veprimet e tyre, praninë e faktorëve të shumtë rëndues, rëndësinë e parandalimit dhe mungesën e faktorëve lehtësues të njëmendtë.⁸⁷

a) Pesha dhe pasojat e veprave penale

50. ZPS-ja kujton se dëshmitari 1 u kontaktua disa herë në shtëpinë e tij nga dy prej të akuzuarve, [REDAKTUAR], dhe se këto kontakte u koordinuan nga të tre të akuzuarit si grup, të cilët vepruan si pjesë e një grupi më të madh personash të paidentifikuar, ose në emër të tyre.⁸⁸ Sipas ZPS-së, fakti që [REDAKTUAR], dhe, më përgjithësisht, ndikim shkurajues mbi besimin e publikut në efektshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të DHS-së.⁸⁹ ZPS-ja gjithashtu argumenton se fakti që premtimi shtesë për përfitim u bë gjatë kontaktit të dytë, nxjerr në pah vendosmërinë e të akuzuarve për të përdorur çdo mjet të nevojshëm për arritjen e qëllimit të tyre.⁹⁰

⁸⁷ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 24, 27-30.

⁸⁸ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 46.

⁸⁹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 47-48.

⁹⁰ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 49.

b) Pjesëmarrja e të akuzuarve në veprat penale

51. Z. Shala. ZPS-ja argumenton se veprimet e z. Shala ishin të qëllimshme, këmbëngulëse dhe të koordinuara pasi: (i) ai u takua me z. Bahtijari dhe z. Januzi dhe/ose komunikoi me të dy këta para dhe pas kryerjes së kontakteve; (ii) zgjodhi qëllimisht z. Bahtijari dhe z. Januzi, [REDAKTUAR], si ndërmjetës të tij për të siguruar efektshmëri sa më të lartë; kjo qasje tregon se ai ishte i vetëdijshëm se orvatja e tij ishte kriminale; (iii) ai i ngarkoi z. Bahtijari dhe z. Januzi detyrën për të bindur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë; dhe (iv) kur u duk se kontakti që kreu z. Bahtijari nuk solli tërheqjen e dëshmisë së dëshmitarit, z. Shala e udhëzoi z. Januzi që të ofronte “ndihmë”.⁹¹

52. Z. Januzi. ZPS-ja parashtron se veprimet e z. Januzi ishin të qëllimshme, të koordinuara dhe ngulmuese pasi: (i) ai kreu komunikime me z. Shala dhe z. Bahtijari para dhe (pas) kontakteve; dhe (ii) shkoi në shtëpinë e dëshmitarit 1 afërsisht një javë pasi z. Bahtijari kishte qenë atje dhe i tha dëshmitarit 1, ndër të tjera, se kishte ardhur në vazhdim të kontaktit të parë dhe se disa persona të tjerë të panjohur i ofronin “ndihmë” dëshmitarit 1 në shkëmbim të pajtimit të tij për të mos dhënë dëshmi.⁹²

53. Z. Bahtijari. ZPS-ja parashtron se z. Bahtijari tregoi këmbëngulje në veprimet e tij pasi ai: (i) i telefonoi dëshmitarit 1, mësoi se dëshmitari 1 ishte në shtëpi dhe më pas shkoi në shtëpinë e tij pa ftesë; (ii) përcolli mesazhin se dëshmitari 1 nuk duhej të jepte dëshmi në DHS; dhe (iii) vijoi të kishte komunikime të vazhdueshme me z. Shala dhe z. Januzi, si para ashtu dhe pas kontaktit të parë.⁹³

⁹¹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 51-55.

⁹² Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 56-58.

⁹³ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 59.

c) Rrethana rënduese

54. Si rrethana rënduese ZPS-ja rendit: (i) përfshirjen e disa viktimave, sipas kuptimit të rregullës 163(1)(b)(iv) të Rregullores; dhe (ii) cenueshmërinë e viktimave, sipas kuptimit të rregullës 163(1)(b)(iii) të Rregullores, duke pasur parasysh atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe [REDAKTUAR].⁹⁴

55. Sa u përket z. Shala dhe z. Januzi, ZPS-ja gjithashtu parashtroi se të dy ata kanë precedentë penalë të mëhershëm në Kosovë.⁹⁵ [REDAKTUAR].⁹⁶ [REDAKTUAR].⁹⁷ [REDAKTUAR].⁹⁸

d) Rrethana lehtësuese

56. ZPS-ja parashtroi se, ndonëse Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë do të rezultojnë në uljen e dënimeve, në përputhje me rregullën 163(2) të Rregullores, për të akuzuarit nuk ka rrethana të tjera lehtësuese.⁹⁹ ZPS-ja thekson se: (i) bashkëpunimi në formën e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë nuk ndodhi deri pak para gjykimit; (ii) në rastet kur dhanë intervista vullnetarisht, të akuzuarit mohuan se kishin kryer veprime të jashtëligjshme; dhe (iii) me gjithë pranimin prej të akuzuarve të përfshirjes

⁹⁴ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 60.

⁹⁵ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 61; Parashtrimet Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 2.

⁹⁶ Parashtrimet Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 5-7.

⁹⁷ Parashtrimet Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 6-7; *shih gjithashtu* transkriptin e 18 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 454-456.

⁹⁸ Parashtrimet Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 8-11. Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtroi se rregulla 163(1)(b) e Rregullores nuk e kufizon Trupin Gjykoës që të marrë parasysh *vetëm* rrethanat rënduese të renditura në të, *p.sh.* verdiktet e mëparshme të fajësisë penale, por përkundrazi, Trupi Gjykoës mund të marrë parasysh dhe informacione të tjera relevante, [REDAKTUAR], *shih* transkriptin e 18 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 493, 495-496. ZPS-ja i bëri këto parashtrime në përgjigje të argumenteve të paraqitura nga Mbrojtja e Januzit në lidhje me [REDAKTUAR], *shih më poshtë* para. 64.

⁹⁹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 24, 66.

së “të tjerëve” në veprat penale, ata ende nuk i kanë identifikuar këta persona për ZPS-në.¹⁰⁰ Në këtë kontekst dhe duke marrë parasysh peshën e veprave penale, ZPS-ja parashtron se argumenteve të mundshme për karakterin e mirë të cilitdo prej të akuzuarve, nuk duhet t’u jepet peshë e konsiderueshme.¹⁰¹

57. Në lidhje me z. Bahtijari në veçanti, ZPS-ja pretendon se Mbrojtja e Bahtijarit nuk vërtetoi se aftësia e tij për të kuptuar llojin, rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij në kohën e kryerjes së veprave penale, u zvogëlua ndjeshëm për shkak të gjendjes shëndetësore të tij.¹⁰² ZPS-ja gjithashtu argumenton se, gjithsesi, kur dha rekomandimin e saj për dënimin, i dha peshën e duhur gjendjes shëndetësore të z. Bahtijari.¹⁰³

e) Dënimet e kërkuara

58. ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të shqiptojë dënimet e mëposhtme ndaj të akuzuarve:

- (i) Për z. Shala: (i) **Pika 1:** 36 muaj burgim; (ii) **Pika 2:** 36 muaj burgim; dhe (iii) **Dënim i njësuar:** 36 muaj burgim;
- (ii) Për z. Januzi: (i) **Pika 1:** 30 muaj burgim; (ii) **Pika 2:** 30 muaj burgim; dhe (iii) **Dënim i njësuar:** 30 muaj burgim; dhe

¹⁰⁰ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 67; *shih gjithashtu* transkriptin e 18 dhjetorit 2024, f. 456 (në lidhje me z. Shala); transkriptin e 18 dhjetorit 2024, f. 517-518 (në lidhje me z. Januzi).

¹⁰¹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 69.

¹⁰² Transkripti i 19 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 581-582.

¹⁰³ Transkripti i 19 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 582.

(iii) Për z. Bahtijari: (i) **Pika 1:** 24 muaj burgim; (ii) **Pika 2:** 24 muaj burgim; dhe (iii) **Dënim i njësuar:** 24 muaj burgim.¹⁰⁴

59. Lidhur me kërkesën e Mbrojtjes së Januzit për dënim me kusht,¹⁰⁵ ZPS-ja parashtron se dënimi me 30 muaj burgim që do të mbahej në burg, do të ishte dënim i drejtë, i duhur dhe i domosdoshëm, duke pasur parasysh peshën e veprave penale të z. Januzi, rolin dhe veprimet konkrete të tij, si dhe rëndësinë e parandalimit.¹⁰⁶

2. Mbrojtja e Shalës

60. Mbrojtja e Shalës argumenton se shqiptimi i një dënimi me tre vjet burgim me marrëveshje, është në përputhje me dispozitat ligjore që zbatohen në DHS dhe do të sigurojë që interesat e drejtësisë të merren parasysh si duhet, sikurse kërkohet në bazë të rregullës 94(5)(f) të Rregullores.¹⁰⁷

61. Më konkretisht, Mbrojtja e Shalës argumenton se për z. Shala ekzistojnë një numër faktorësh lehtësues, të cilët ZPS-ja nuk i merr parasysh.¹⁰⁸ Lidhur me

¹⁰⁴ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Dënimin, para. 75.

¹⁰⁵ *Shih më poshtë* paragrafin 65.

¹⁰⁶ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 512-513.

¹⁰⁷ Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin, para. 7, 38. Mbrojtja e Shalës gjithashtu parashtron se përfundimi se dhënia e një dënimi me tre vjet burgim është në interes të drejtësisë, përforcohet nga praktika e të drejtës penale ndërkombëtare, përfshirë procesin gjyqësor në çështjen KSC-BC-2020-07. *Shih* Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin, para. 16-33.

¹⁰⁸ Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin, para. 9-14; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 446-447. Në lidhje me Pikën 1, Mbrojtja e Shalës argumenton, ndër të tjera, se: (i) në faktet e pranuara nuk thuhet se z. Shala pengoi realisht persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, por vetëm lihet të kuptohet se pati një tentativë për ta bërë këtë; (ii) veprimi i fajshëm i veprës penale është i një shkalle relativisht të vogël pasi përbëhet nga vetëm një kontakt me një individ në dy ditë; (iii) komunikimet e z. Shala me të akuzuarit e tjerë me të janë veprime të vetëkuptueshme në një vepër penale që kërkon pjesëmarrje në një grup personash që pengon ose tenton të pengojë me veprime të përbashkëta; dhe (iv) nuk ka pasur shpërdorim të kompetencave ose të detyrës zyrtare nga z. Shala. Në lidhje me Pikën 2, Mbrojtja e Shalës argumenton, ndër të tjera, se: (i) z. Shala është pajtuar se është fajtor për dhënien e udhëzimeve

pretendimin e ZPS-së për mungesë bashkëpunimi nga ana e z. Shala, Mbrojtja e Shalës parashtrohet se ky është një aspekt të cilin ZPS-ja nuk e ka ngritur asnjëherë më parë dhe se argumentet e ZPS-së në lidhje me të nuk duhet të kenë ndikim në përcaktimin e karakterit të z. Shala.¹⁰⁹ Sa u përket dënimeve penale të mëparshme të z. Shala të cilave u referohet ZPS-ja, Mbrojtja e Shalës parashtrohet se këto dënime janë në kufirin e poshtëm të shkallëzimit të dënimit, çka pasqyrohet në dënimet me kusht që i janë dhënë z. Shala.¹¹⁰

62. Mbrojtja e Shalës gjithashtu parashtrohet se, duke pasur parasysh llojin dhe përmbajtjen e veprave penale, si dhe faktin se ai bëri marrëveshje për pranimin e fajësisë, dënim i duhur për të do të ishte një dënim në kufirin e poshtëm të shkallëzimit të dënimit të zbatueshëm.¹¹¹ Së fundi, Mbrojtja e Shalës argumenton se një dënim i gjatë me burgim do të kishte një efekt veçanërisht dëmtues mbi z. Shala dhe familjen e tij.¹¹²

3. Mbrojtja e Januzit

63. Mbrojtja e Januzit parashtrohet se dënim i duhur për z. Januzi është një dënim në kufirin e poshtëm të shkallëzimit të dënimit për të cilin është arritur pajtim me ZPS-

anëtarëve të grupit për të nxitur dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi nëpërmjet premtimit të një përfitimi, dhe jo me anë të përdorimit të forcës ose kërcënimit të rëndë, apo me ndonjë mënyrë tjetër detyrimi dhe, rrjedhimisht, vepra penale e përfshirë në Pikën 2 është ndër më pak të rëndat nga ato të renditura në nenin 387 të KPK-së; dhe (ii) vepra penale është e një shkalle relativisht të vogël.

¹⁰⁹ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 448-449, 458.

¹¹⁰ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 449-450.

¹¹¹ Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin, para. 8, 13, 15.

¹¹² Parashtrimet e Shalës në lidhje me Dënimin, para. 34. Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Shalës u referohet katër letrave rekomanduese të bashkëngjitura Parashtrimeve të Shalës në lidhje me Dënimin, të cilat tregojnë respektin e lartë që z. Shala gëzon nga familja e tij dhe komuniteti, dhe kontributin që ai ka dhënë për ta dhe vendin e tij.

në, konkretisht ai me 24 muaj.¹¹³ Konkretisht, Mbrojtja e Januzit parashtrohet se: (i) z. Januzi veptroi sipas udhëzimeve; (ii) ai u takua me dëshmitarin 1 vetëm një herë; (iii) nxitja që u bë ishte thjesht një ofertë e pasaktësuar për “ndihmë”; (iv) [REDAKTUAR] ndaj tij nuk u bë asnjë përpjekje e mëtejshme për ta nxitur që të mos jepte dëshmi; (v) [REDAKTUAR]; dhe (vi) nuk ka asgjë që të lë të kuptosh se, si rezultat i veprimeve të z. Januzi, u pengua ose u vonua një veprim i ndonjë zyrtari të DHS-së dhe/ose ZPS-së.¹¹⁴

64. Mbrojtja e Januzit gjithashtu pretendon se asnjë prej rrethanave rënduese të renditura në rregullën 163(1)(b) të Rregullores, nuk ekziston në lidhje me z. Januzi,¹¹⁵ pasi ai nuk ka dënime të mëparshme relevante,¹¹⁶ dhe është person me karakter të mirë.¹¹⁷ Sa i përket ekzistencës së rrethanave lehtësuese, Mbrojtja e Januzit parashtrohet se duhet të merren parasysh faktorët në vijim: (i) fakti se z. Januzi bëri marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe fakti se arritja e kësaj marrëveshjeje i kurseu gjykatës kohë dhe shpenzime të konsiderueshme; (ii) pendimi i z. Januzi;¹¹⁸ (iii) fakti që ai nuk ka dënime të mëparshme relevante në dosjen e tij; (iv) fakti se para arrestimit, ai bashkëpunoi me ZPS-në dhe qëndroi në vendbanimin e tij, duke e ditur se ishte nën

¹¹³ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin, para. 14.

¹¹⁴ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin, para. 15-20.

¹¹⁵ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin, para. 21.

¹¹⁶ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

¹¹⁷ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 490-492.

¹¹⁸ Gjatë seancave për pranimin e fajësisë, në përgjigje të pyetjeve që i bëri Kryegjykatësja, z. Januzi konfirmoi se kishte reflektuar mbi kohën e kaluar prej tij në paraburgim dhe se ishte penduar për veprimet kriminale të tij. Ai deklaroi: “Jam penduar për çka kam bërë. [...] Tani që e kuptoj rëndësinë e kësaj çështjeje, sigurisht që nuk do ta bëja më kurrë”. *Shih* transkriptin e 18 dhjetorit 2024, f. 520-521.

hetim; dhe (v) rrethanat personale dhe karakteri i tij, përfshirë lidhjet e forta të tij me popullatën vendase, si dhe mjetet modeste financiare të tij.¹¹⁹

65. Së fundi, Mbrojtja e Januzit fton Trupin Gjykses të urdhërojë që dënimi me burgim ndaj z. Januzi të mos zbatohet, përveç nëse ai kryen një vepër tjetër penale gjatë një periudhe verifikimi prej jo më pak se një viti.¹²⁰

4. Mbrojtja e Bahtijarit

66. Mbrojtja e Bahtijarit argumenton se veprat penale në këtë çështje nuk kanë pasur pasoja të përhershme ose të rënda për rendin publik ose administrimin e drejtësisë, duke pasur parasysh se veprimet e kufizuara të z. Bahtijari përfshinë vetëm një dëshmitar, të cilin ai as e kërcënoi, as e lëndoi, [REDAKTUAR].¹²¹ Mbrojtja e Bahtijarit paraqiti argumente edhe për karakterin e mirë të z. Bahtijari,¹²² për dosjen e problemeve shëndetësore të tij në të kaluarën dhe të tashmen (të cilat kufizuan aftësinë mendore të tij në kohën e kryerjes së veprave penale, çka përlligj zbutjen e dënimit të tij),¹²³ dhe rrethanat familjare.¹²⁴ Mbrojtja e Bahtijarit gjithashtu argumenton se z.

¹¹⁹ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin, para. 22-35.

¹²⁰ Parashtrimet e Januzit në lidhje me Dënimin, para. 36; transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 510-512. Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Januzit parashtron se Trupi Gjykses ka diskrecion ta bëjë këtë në bazë të neneve 48(1)-(2) dhe (4) dhe 71(1.1.3) të KPK-së dhe se një urdhër i tillë do të promovonte parimet e rehabilitimit dhe parandalimit, duke krijuar një motiv të fuqishëm për të mos shkelur përsëri ligjin.

¹²¹ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 26-27, 67.

¹²² Mbrojtja e Bahtijarit i referohet në veçanti reputacionit dhe pozitës së z. Bahtijari në komunitetin e tij, *shih* Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 29 dhe Shtojcat 2-3 që përmbajnë letra rekomanduese nga familjarë të z. Bahtijari dhe anëtarë të komunitetit.

¹²³ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 32-50, 53-54, 67. Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Bahtijarit argumenton se: (i) z. Bahtijari nuk i kreu veprat penale me një shkallë të lartë vullneti; (ii) aftësia e tij për të gjykuar mbi veprimet dhe vendimet e tij ishte e ulur; dhe (iii) gjasat ishin më të mëdha që ai t'u bindej udhëzimeve.

¹²⁴ Mbrojtja e Bahtijarit argumenton se arrestimi i z. Bahtijari pati ndikim te familja e z. Bahtijari, *shih*, Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 30-31.

Bahtijari veptoi sipas udhëzimeve të z. Shala dhe luajti një rol të vogël në kryerjen e veprave penale.¹²⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Bahtijarit i kërkon Trupit Gjykses të marrë parasysh mungesën e motivit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprave penale, në veçanti, bashkëpunimin e tij me ZPS-në gjatë dhe pas arrestimit dhe sjelljen e kënaqshme të tij gjatë paraburgimit.¹²⁶

67. Për më tepër, Mbrojtja e Bahtijarit parashtroi se ndaj z. Bahtijari nuk ka rrethana rënduese, pasi ai nuk ka dënime penale të mëparshme, nuk ka pasur shpërdorim të kompetencave ose të detyrës zyrtare dhe veprat penale që ai ka kryer nuk përfshijnë viktima veçanërisht të cenueshme ose kryerje të akteve mizore.¹²⁷ Sipas Mbrojtjes së Bahtijarit, faktorët lehtësues dhe të favorshëm, në qoftë se merren parasysh në tërësinë e tyre, përlligjin dhënien e një dënimi me zgjatje sa koha e kaluar tashmë në paraburgim dhe lirimin e z. Bahtijari sa më shpejt të jetë e mundur.¹²⁸

68. Së fundi, Mbrojtja e Bahtijarit parashtroi se, duke pasur parasysh mungesën e mjeteve financiare dhe gjendjen shëndetësore të tij, çdo gjobë duhet të konsiderohet si e mbuluar plotësisht nga koha e kaluar në paraburgim, dhe çdo dënim i mëtejshëm, me burg ose financiar, do të ishte shproporcionalisht i ashpër.¹²⁹

B. KORNIZA LIGJORE

¹²⁵ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 55-57, 67.

¹²⁶ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 58-61.

¹²⁷ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 22.

¹²⁸ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 23, 63-65, 67, 69; transkripti i 19 dhjetorit 2024, f. 564-565, 579.

¹²⁹ Parashtrimet e Bahtijarit në lidhje me Dënimin, para. 65-66, 68.

69. *Qëllimi i dënimit.* Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se, siç përcaktohet në jurisprudencën e DHS-së,¹³⁰ qëllimet parësore të dënimit janë parandalimi¹³¹ dhe ndëshkimi;¹³² rehabilitimi¹³³ është i rëndësishëm por nuk duhet të luajë rol mbizotërues. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se dënimi duhet gjithashtu të pasqyrojë thirrjen për drejtësi nga personat që kanë qenë – drejtpërdrejt ose tërthorazi – viktimat të veprës ose veprave penale. Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e dëmit dhe vuajtjeve që u janë shkaktuar atyre dhe shoqërisë.¹³⁴

70. *Përcaktimi i dënimit.* Për përcaktimin e dënimit për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, në bazë të nenit 3(2)(b)-(c) dhe (4) të Ligjit, Trupi Gjykses zbaton dispozitat e nenit 44(4)-(5) të Ligjit dhe rregullës 163(1)-(4) dhe (6) të Rregullores, dhe dënimi në fjalë duhet të jetë në përputhje me dënimet e përcaktuara në KPK për ato vepra penale.

71. *Evidentimi dhe balancimi i faktorëve relevantë.* Trupi Gjykses së pari evidenton faktorët relevantë në bazë të nenit 44(5) të Ligjit dhe rregullës 163(1)-(3) të Rregullores dhe, së dyti, i peshon dhe balancon të gjithë këta faktorë dhe përcakton dënimin.

72. Faktorë relevantë për përcaktimin e dënimit janë: (i) në radhë të parë, pesha e veprës penale dhe pasojat e saj; (ii) kontributi personal i personit të shpallur fajtor në

¹³⁰ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1060.

¹³¹ Në lidhje me parandalimin, Trupi Gjykses kujton se dënimi duhet të jetë i tillë që të shkurajojë përsëritjen e krimit nga personi i dënuar (parandalimi individual), si dhe të synojë të shkurajojë kryes të tjerë të mundshëm nga kryerja e krimeve të njëjta apo të ngjashme (parandalimi i përgjithshëm). Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1060.

¹³² Ndëshkimi kuptohet si dhënie e dënimit të duhur që pasqyron fajësinë e personit të dënuar, por nuk duhet të shprehë hakmarrje apo shpagim. Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1060.

¹³³ Rehabilitimi përqendrohet në riintegrimin e personit të dënuar në shoqëri. Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1060.

¹³⁴ Shih nenin 38(1)(1.3) të KPK-së, ku thuhet se një nga qëllimet e dënimit është “të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale”. Shih gjithashtu [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1063.

veprën ose veprat penale; dhe (iii) rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor (tri kategoritë). Gjithashtu, Trupi Gjykses mund të shqyrtojë ekzistencën e rrethanave lehtësuese dhe rënduese sipas cilësdo prej këtyre tri kategorive.¹³⁵

73. Pësha matet *in abstracto*, duke analizuar llojin e veprës penale në terma të përgjithshme dhe *in concreto*, duke vlerësuar rrethanat konkrete të çështjes.¹³⁶ Kur vlerëson peshën e veprës penale, Trupi Gjykses shqyrton llojin, kuadrin, si dhe rrethanat dhe pasojat e saj.¹³⁷ Treguesit e peshës së veprës penale përfshijnë, ndër të tjera, shkallën e krimit, numrin e viktimave, cenueshmërinë e viktimave, moshën e viktimave, shkallën e vuajtjes së viktimave dhe ndikimin tek të afërmit.¹³⁸ Faktorët që merren parasysh si elemente të peshës së krimit nuk mund të merren parasysh edhe si rrethana rënduese më vete dhe anasjellas.¹³⁹

74. Në lidhje me kontributin personal në veprën ose veprat penale, Trupi Gjykses shqyrton rolin dhe pozitën e personit të shpallur fajtor, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës ose veprave penale dhe shkallën e synimit.¹⁴⁰

¹³⁵ Shih KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Appeal Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit), 14 dhjetor 2023, publik, para. 458; [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1072.

¹³⁶ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1077.

¹³⁷ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1076; shih gjithashtu [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 951 dhe referencat në të.

¹³⁸ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1078; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 951 dhe referencat në të.

¹³⁹ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1078. Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3484-tENG-Corr, Trial Chamber II, [Decision on Sentence pursuant to article 76 of the Statute](#), 23 May 2014, para. 35.

¹⁴⁰ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1079.

75. Në lidhje me rrethanat individuale, Trupi Gjykses shqyrton rrethanat personale të personit të shpallur fajtor, siç janë mosha, gjendja shëndetësore, gjendja familjare, arsimimi, precedentët e mëhershëm penalë¹⁴¹ ose karakteri.¹⁴²

76. Në këtë çështje, Trupi Gjykses do të marrë parasysh edhe lidhjen e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë të cilat, në bazë të rregullës 163(2) të Rregullores, duhet të sjellin ulje të dënimit. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses do të marrë parasysh kohën kur janë bërë Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë.

77. Rrethanat lehtësuese duhet të lidhen drejtpërdrejt me personin e shpallur fajtor; sidoqoftë, nuk është nevoja që ato të lidhen drejtpërdrejt me veprën ose veprat penale dhe nuk kufizohen në kuadrin e akuzës ose akuzave.¹⁴³ Trupi Gjykses duhet të bindet për ekzistencën e rrethanave lehtësuese në bazë të tërësisë së gjasave.¹⁴⁴ Ekzistenca e rrethanave lehtësuese nuk e pakëson peshën e veprës ose veprave penale, por bëhet relevante për uljen e dënimit.¹⁴⁵

78. Rrethanat rënduese duhet të kenë lidhje me veprën ose veprat penale për të cilat personi është shpallur fajtor ose me vetë personin.¹⁴⁶ Trupi Gjykses duhet të bindet jashtë dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e rrethanave rënduese.¹⁴⁷ Mungesa e rrethanave lehtësuese nuk shërben si rrethanë rënduese.¹⁴⁸ Së fundi, një element i veprës ose veprave penale ose i formës së përgjegjësisë penale nuk mund të

¹⁴¹ Rregulla 163(3) e Rregullores.

¹⁴² Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1080.

¹⁴³ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1081.

¹⁴⁴ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1081.

¹⁴⁵ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1081.

¹⁴⁶ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1082.

¹⁴⁷ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1082.

¹⁴⁸ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1082.

konsiderohet në të njëjtën kohë edhe si rrethanë rënduese e po asaj veprë penale ose e po atyre veprave penale.¹⁴⁹

79. Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale për të peshuar dhe balancuar faktorët e lartpërmendur kur përcakton dënimin.¹⁵⁰ Trupi Gjykses duhet të shpjegojë peshën që u është dhënë këtyre rrethanave dhe provat konkrete mbi të cilat është mbështetur.¹⁵¹ Po kështu, Trupi Gjykses ka një shkallë të konsiderueshme diskrecioni, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, për të përcaktuar se çfarë përbën rrethanë lehtësuese apo rënduese, krahas atyre të përcaktuara shprehimisht në rregullën 163(1) të Rregullores.¹⁵² Së fundi, personi i shpallur fajtor duhet të vihet mjaftueshëm në dijeni për faktet që janë marrë parasysh për rëndimin e dënimit.¹⁵³

80. *Përcaktimi i dënimit.* Në përcaktimin e dënimit të duhur, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh marrëveshjen e arritur midis secilit të akuzuari dhe ZPS-së në lidhje me dënimin ose shkallëzimin e dënimit që do të jepet, në përputhje me rregullën 94(2)(b) të Rregullores. Sidoqoftë, Trupi Gjykses kujton se, në bazë të rregullës 94(6) të Rregullores, këto lloj marrëveshjesh nuk janë detyruese për Trupin Gjykses dhe ai mund t'u propozojë palëve ndryshime për shqyrtim prej tyre.

81. Në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, Trupi Gjykses përcakton dënimin në lidhje me çdo akuzë të aktakuzës së konfirmuar, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të

¹⁴⁹ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1082.

¹⁵⁰ Shih, *ndër të tjera*, nenin 44(5) të Ligjit; rregullën 163(1)(a)-(b) të Rregullores. Shih gjithashtu [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1073.

¹⁵¹ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1075.

¹⁵² Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1074.

¹⁵³ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Shala), para. 1075.

personit të shpallur fajtor. Dënimi i njësuar nuk duhet të jetë më i lehtë se dënimi më i rëndë i përcaktuar për cilëndo prej akuzave.¹⁵⁴ Së fundi, në bazë të rregullës 163(6) të Rregullores, gjatë dhënies së dënimit me burgim, Trupi Gjykses zbret kohën gjatë së cilës personi i shpallur fajtor është mbajtur në paraburgim, në rast se është mbajtur në paraburgim para ose gjatë gjykimit.¹⁵⁵

C. KONSTATIME

1. Z. Shala

82. Trupi Gjykses konstaton se veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1) dhe frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2), sipas neneve 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së, për të cilat z. Shala është shpallur fajtor, janë të rënda për arsyet në vijim: (i) veprat penale kundër administrimit të drejtësisë përbëjnë cenim të rëndë të sigurisë dhe integritetit të proceseve gjyqësore, dëmtojnë zbulimin e të vërtetës dhe pengojnë drejtësinë për viktimat dhe për shoqërinë në përgjithësi;¹⁵⁶ (ii) z. Shala, me anë të veprimeve të tij të paligjshme, frikësoi dëshmitarin 1 [REDAKTUAR];¹⁵⁷ (iii) veprimet e paligjshme të z. Shala patën ndikim mbi besimin e publikut në efektshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të DHS-së; dhe

¹⁵⁴ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1084.

¹⁵⁵ Shih [Shala Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Shala*), para. 1085.

¹⁵⁶ Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 951. Shih gjithashtu KSC-SC-2023-01/CS001, F00002, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, [Decision on Commutation, Modification or Alteration of Sentence](#) (Vendim mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit) (Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit të *Gucatit*), 12 tetor 2023, publik, para. 37, me Shtojca, konfidenciale dhe *ex parte*; ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13, Trial Chamber VII, [Decision on Sentence Pursuant to Article 76 of the Statute](#) (*Bemba et al.* Sentencing Decision), 22 March 2017, para. 46; IRMCT, *Prosecutor v. Nzabonimpa et al.*, MICT-18-116, Single Judge, [Judgement](#) (*Nzabonimpa et al.* Trial Judgement), 25 June 2021, para. 397.

¹⁵⁷ [REDAKTUAR].

(iv) veprat penale ishin pjesë e një plani për të nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi në procesin e DHS-së, plan ky i koordinuar nga një grup personash, konkretisht nga z. Shala, të akuzuarit e tjerë me të dhe persona të tjerë të paidentifikuar. Fakti që, siç argumenton Mbrojtja e Shalës,¹⁵⁸ kontaktet ndodhën vetëm në dy ditë, gjatë tyre nuk u bë ndonjë “kërcënim real” por vetëm një premtim për dhënie të hollash, dhe në to u përfshinë vetëm dy persona, nuk eliminon rëndesën dhe peshën e veprave penale.

83. Trupi Gjykses gjithashtu merr parasysh rolin e spikatur të z. Shala në drejtimin dhe orkestrimin e qëllimshëm të kryerjes së veprave penale, përmes z. Januzi dhe z. Bahtijari, siç përshkruhet hollësisht më lart.¹⁵⁹

84. Trupi Gjykses ka marrë parasysh gjithashtu rrethanat personale dhe familjare të z. Shala, si dhe dosjen penale të tij, ku përfshihen dënime për vepra penale që lidhen me veprat penale për të cilat ai është shpallur fajtor në çështjen aktuale, dhe të cilat demonstrojnë se z. Shala nuk ka frikë të përfshihet në veprime kriminale për të arritur qëllimet e tij.¹⁶⁰ Për më tepër, Trupi Gjykses vë në dukje se z. Shala nuk tregoi pendim.

85. Si faktorë lehtësues, Trupi Gjykses thekson faktin se: (i) pranimi i fajësisë nga z. Shala dhe lidhja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë para nisjes së gjykimit, është në interes të drejtësisë, ofron në njëfarë mase lehtësim shpirtëror dhe njohje të dëmit për V01/10-en dhe përmbyllje dhe qartësi për procesin;¹⁶¹ dhe (ii) z. Shala, pas ndërhyrjes së Trupit Gjykses, pranoi t’i paguajë zhdëmtime V01/10-ës.

¹⁵⁸ *Shih më lart* poshtëshënimin 108.

¹⁵⁹ *Shih më lart* paragrafin 26.

¹⁶⁰ *Shih* Shtojcën 1 të Parashtrimeve Shtesë të ZPS-së në lidhje me Dënimin.

¹⁶¹ *Shih më lart* paragrafin 20.

86. Duke pasur parasysh qëllimet e dënimit dhe pasi ka peshuar dhe balancuar të gjithë faktorët e përmendur më lart, Trupi Gjykses miraton dënimin për të cilin është arritur pajtim midis ZPS-së dhe z. Shala dhe e dënon z. Shala:

- (i) me tre (3) vjet burgim për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 1); dhe
- (ii) me tre (3) vjet burgim për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2).

87. Pasi ka përcaktuar dënimet e mësipërme, Trupi Gjykses cakton për z. Shala dënimin e njëzuar me tre (3) vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të tij dhe veprat penale që ka kryer.

88. Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses thekson se z. Shala u arrestua më 11 dhjetor 2023¹⁶² dhe është mbajtur në paraburgim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që nga data 12 dhjetor 2023.¹⁶³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga 11 dhjetori 2023.

2. Z. Januzi

89. Trupi Gjykses rikujton se veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1) dhe frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2),

¹⁶² KSC-BC-2023-11, F00008, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Haxhi Shalës sipas Rregullës 55(4)*, 11 dhjetor 2023, publik, para. 4.

¹⁶³ KSC-BC-2023-11, F00011, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 dhjetor 2023, publik, para. 2, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

sipas neneve 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së, për të cilat z. Januzi është shpallur fajtor, janë të rënda për arsyet në vijim: (i) veprat penale kundër administrimit të drejtësisë përbëjnë cenim të rëndë të sigurisë dhe integritetit të proceseve gjyqësore, dëmtojnë zbulimin e të vërtetës dhe pengojnë drejtësinë për viktimat dhe për shoqërinë në përgjithësi;¹⁶⁴ (ii) z. Januzi, me anë të veprimeve të tij të paligjshme, në veçanti me ofertën për “ndihmë”, frikësoi dëshmitarin 1 [REDAKTUAR];¹⁶⁵ (iii) veprimet e paligjshme të z. Januzi patën ndikim të drejtpërdrejtë mbi besimin e publikut në efektshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të DHS-së; dhe (iv) veprat penale ishin pjesë e një plani për të nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi në procesin e DHS-së, plan ky i koordinuar nga një grup personash, konkretisht nga z. Januzi, të akuzuarit e tjerë me të dhe persona të tjerë të paidentifikuar. Fakti se, siç argumenton Mbrojtja e Januzit,¹⁶⁶ z. Januzi u takua me dëshmitarin 1 vetëm në një rast ose se veprimet e tij përfshinë vetëm një ofertë për “ndihmë”, e jo forcë ose kërcënim të rëndë, nuk eliminon rëndesën dhe peshën e veprave penale. Po kështu, argumenti se [REDAKTUAR]¹⁶⁷ duhet të hidhet poshtë, pasi për veprën penale të frikësimit nuk ka nevojë të provohet se është shkaktuar pasojë.¹⁶⁸ Po kështu, argumenti se nuk u pengua asnjë veprim i zyrtarëve të ZPS-

¹⁶⁴ Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 951. Shih gjithashtu [Gucati Modification Decision](#) (Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit të Gucatit), para. 37; [Bemba et al. Sentencing Decision](#), para. 46; [Nzabonimpa et al. Trial Judgement](#), para. 397.

¹⁶⁵ [REDAKTUAR].

¹⁶⁶ Shih më lart paragrafin 63.

¹⁶⁷ Shih më lart paragrafin 63.

¹⁶⁸ Vendimi i Konfirmimit në Çështjen 10, para. 31 dhe referencat në të.

së/DHS-së,¹⁶⁹ është i pathemeltë, pasi neni 401(2) i KPK-së ndëshkon në të njëjtën mënyrë pengimin dhe tentativën për pengim.¹⁷⁰

90. Trupi Gjykses ka marrë parasysh gjithashtu se z. Januzi, nën udhëzimet e z. Shala, kishte dijeni dhe kontribuo qëllimisht në planin për të nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë e tij në procesin e DHS-së ose të mos e jepte atë. Më konkretisht, z. Januzi: (i) komunikoi dhe u koordinua me anëtarët e tjerë të grupit për kontaktet me dëshmitarin 1 para dhe pas dy kontakteve; dhe (ii) ishte ndërmjetës midis dëshmitarit 1, nga njëra anë, dhe z. Shala dhe personave të tjerë të paidentifikuar, nga ana tjetër.¹⁷¹

91. Trupi Gjykses ka marrë parasysh gjithashtu rrethanat personale, financiare dhe familjare të z. Januzi si dhe dosjen penale të tij, në të cilën nuk ka më dënime.

92. Si faktorë lehtësues, Trupi Gjykses i jep peshë faktit se: (i) pranimi i fajësisë nga z. Januzi dhe lidhja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë para nisjes së gjyimit, është në interes të drejtësisë, ofron në njëfarë mase lehtësim shpirtëror dhe njohje të dëmit për V01/10-ën dhe përmbyllje dhe qartësi për procesin;¹⁷² (ii) z. Januzi shprehu pendim për sjelljen kriminale të tij dhe deklaroi se nuk do të kryente sërish veprime të ngjashme;¹⁷³ dhe (iii) pas ndërhyrjes së Trupit Gjykses, ai pranoi t'i paguajë zhdëmtime V01/10-ës.

¹⁶⁹ Shih më lart paragrafin 63.

¹⁷⁰ Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 141.

¹⁷¹ Shih më lart paragrafin 26.

¹⁷² Shih më lart paragrafin 20.

¹⁷³ Transkripti i 18 dhjetorit 2024, f. 520-521.

93. Nga ana tjetër, ndonëse Trupi Gjykses pranon se z. Januzi bashkëpunoi me ZPS-së,¹⁷⁴ Trupi Gjykses kujton se nga çdo person pritët që të veprojë në përputhje me ligjin ose me urdhrat e nxjerra nga gjykata, dhe, për këtë arsye, në vetvete kjo nuk përbën rrethanë lehtësuese, përveçse në raste të veçanta.¹⁷⁵ Trupi Gjykses nuk është bindur se bashkëpunimi i z. Januzi me ZPS-në, përveç lidhjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ka qenë i veçantë dhe, rrjedhimisht, nuk e bën lehtësuese këtë rrethanë.

94. Duke pasur parasysh qëllimet e dënimit dhe pasi ka peshuar dhe balancuar të gjithë faktorët e përmendur më lart, Trupi Gjykses miraton dënimin për të cilin është arritur pajtim midis ZPS-së dhe z. Januzi dhe vendos ta dënojë z. Januzi:

- (i) me dy (2) vjet burgim për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 1); dhe
- (ii) me dy (2) vjet burgim për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2).

95. Pasi ka përcaktuar dënimet e mësipërme, Trupi Gjykses cakton për z. Januzi dënimin e njëzuar me dy (2) vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të z. Januzi dhe veprat penale që ka kryer.

96. Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses thekson se z. Januzi u arrestua më 5 tetor 2023¹⁷⁶ dhe është mbajtur në paraburgim në objektin

¹⁷⁴ Kjo ka të bëjë në veçanti me pranimin prej z. Januzi për t'u intervistuar nga ZPS-ja.

¹⁷⁵ *Shih [Shala Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Shala*), para. 1115.

¹⁷⁶ KSC-BC-2023-10, F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik, para. 4.

e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që nga data 6 tetor 2023.¹⁷⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga 5 tetori 2023.

97. Sa i përket kërkesës së Mbrojtjes së Januzit për dënim me kusht,¹⁷⁸ Trupi Gjykses thekson se dënimi me kusht, sipas neneve 46-48 të KPK-së, është një formë alternative e dënimit. Trupi Gjykses gjithashtu kujton se, sipas rregullës 94 të Rregullores, Trupi Gjykses nuk mund t'i japë të akuzuarit një dënim të ndryshëm nga ai për të cilin janë pajtuar palët, apo një dënim jashtë shkallëzimit të dënimit për të cilin është arritur pajtimi.¹⁷⁹ Duke pasur parasysh se kërkesa për dënim me kusht të z. Januzi nuk ishte pjesë e marrëveshjes së ZPS-së me të për pranimin e fajësisë, Trupi Gjykses rrëzon kërkesën e Mbrojtjes së Januzit për dënim me kusht.

3. Z. Bahtijari

98. Trupi Gjykses rikujton se veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1) dhe frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2), sipas neneve 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së, për të cilat z. Bahtijari është shpallur fajtor, janë të rënda për arsyet në vijim: (i) veprat penale kundër administrimit të drejtësisë përbëjnë cenim të rëndë të sigurisë dhe integritetit të proceseve gjyqësore, dëmtojnë zbulimin e të vërtetës dhe pengojnë drejtësinë për viktimat dhe për shoqërinë në përgjithësi;¹⁸⁰ (ii) z. Bahtijari, me anë të veprimeve të tij të paligjshme, frikësoi dëshmitarin 1 [REDAKTUAR];¹⁸¹ (iii) veprimet e paligjshme të z. Bahtijari

¹⁷⁷ F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimin të Sabit Januzit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, para. 2, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁷⁸ Shih më lart paragrafin 65.

¹⁷⁹ Vendimi F00612, para. 16-17.

¹⁸⁰ Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 951. Shih gjithashtu [Gucati Modification Decision](#) (Vendimi mbi Modifikimin e Dënimit të Gucatit), para. 37; [Bemba et al. Sentencing Decision](#), para. 46; [Nzabonimpa et al. Trial Judgement](#), para. 397.

¹⁸¹ [REDAKTUAR].

ndikuan mbi besimin e publikut në efektshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të DHS-së; dhe (iv) veprat penale ishin pjesë e një plani për të nxitur dëshmitarin 1 të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi në procesin e DHS-së, plan ky i koordinuar nga një grup personash, konkretisht nga z. Bahtijari, të akuzuarit e tjerë me të dhe persona të tjerë të paidentifikuar. Pretendimi i Mbrojtjes së Bahtijarit se veprat penale në këtë çështje nuk patën ndonjë pasojë të përhershme ose të rëndë,¹⁸² [REDAKTUAR].¹⁸³

99. Trupi Gjykses ka marrë parasysh gjithashtu se z. Bahtijari, nën udhëzimet e z. Shala, kishte dijeni dhe kontribuoi qëllimisht në planin për të nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë e tij në procesin e DHS-së ose të mos e jepte atë. Më konkretisht, z. Bahtijari: (i) kontaktoi personalisht dëshmitarin 1 në shtëpinë e tij, pasi u sigurua se dëshmitari 1 ndodhej vërtet atje; dhe (ii) komunikoi dhe u koordinua me anëtarët e tjerë të grupit për kontaktet me dëshmitarin 1 para dhe pas kontaktit të parë dhe para kontaktit të dytë.¹⁸⁴

100. Trupi Gjykses ka marrë parasysh gjithashtu rrethanat personale, financiare dhe familjare të z. Bahtijari si dhe gjendjen shëndetësore aktuale të tij.

101. Si faktorë lehtësues, Trupi Gjykses i jep peshë faktit se: (i) pranimi i fajësisë nga z. Bahtijari dhe lidhja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë para hapjes së procesit gjyqësor, është në interes të drejtësisë, ofron në njëfarë mase lehtësim shpirtëror dhe njohje të dëmit për V01/10-en dhe përmbyllje dhe qartësi për procesin;¹⁸⁵ dhe (ii) z. Bahtijari shprehu pendim për veprimet kriminale të tij.¹⁸⁶ Përveç lidhjes së marrëveshjes me ZPS-në për pranimin e fajësisë, Trupi Gjykses nuk i konsideron

¹⁸² *Shih më lart* para. 66.

¹⁸³ [REDAKTUAR].

¹⁸⁴ *Shih më lart* para. 26.

¹⁸⁵ *Shih më lart* para. 20.

¹⁸⁶ Transkripti i 19 dhjetorit 2024, konfidencial, f. 590-591.

faktorë lehtësues respektimin e urdhrave të gjykatës prej z. Bahtijari dhe sjelljen e mirë të tij në paraburgim.

102. Duke pasur parasysh qëllimet e dënimit dhe pasi ka peshuar dhe balancuar të gjithë faktorët e përmendur më lart, Trupi Gjykues miraton dënimin për të cilin është arritur pajtim midis ZPS-së dhe z. Bahtijari dhe vendos ta dënojë z. Bahtijari:

- (i) me dy (2) vjet burgim për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 1); dhe
- (ii) me dy (2) vjet burgim për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale (Pika 2).

103. Pasi ka përcaktuar dënimet e mësipërme, Trupi Gjykues i shqipton z. Bahtijari dënimin e njësuar me dy (2) vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të tij dhe veprat penale që ka kryer.

104. Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykues thekson se z. Bahtijari u arrestua më 5 tetor 2023¹⁸⁷ dhe është mbajtur në paraburgim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që nga data 6 tetor 2023.¹⁸⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues zbret nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga 5 tetori 2023.

¹⁸⁷ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtijarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik, para. 4.

¹⁸⁸ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, para. 2, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

VII. ZHDËMTIMET

A. VENDIMI I 29 JANARIT 2025

105. Trupi Gjykses kujton se në Vendimin e 29 janarit 2025 theksoi se personat fizikë mund të jenë viktimë në kuadër të veprave penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, me kusht që të përfshihen në përkufizimin e dhënë në nenin 22(1) të Ligjit.¹⁸⁹

106. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se, në vijim të vlerësimit të kërkesës për pjesëmarrje si viktimë, ai u shpreh se ishte bindur se kishte prova *prima facie* se V01/10 pësoi personalisht dëm mendor në formën e ankthit, si rezultat i drejtpërdrejtë i [REDAKTUAR], që përbëjnë vepra penale të përshkruara në Aktakuzën e 17 dhjetorit 2024 dhe në faktet e pranuar dhe pranoi V01/10-ën si viktimë në këtë çështje.¹⁹⁰

107. Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se, pasi ka marrë parasysh fazën e avancuar të procesit, ku marrëveshjet për pranimin e fajësisë tashmë ishin bërë, dhe nevojën për të përfunduar sa më shpejt procesin, si dhe shkallën e kufizuar të dëmit të pësuar nga V01/10, çka, rrjedhimisht, bëri të panevojshme paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me zhdëmtimet prej Mbrojtësit të Viktimave, Trupi Gjykses vendosi: (i) se nuk përlligjej emërimi i një Mbrojtësi të Viktimave; (ii) të procedonte *proprio motu* në lidhje me zhdëmtimet, sipas nenit 22(7) të Ligjit; dhe (iii) në lidhje me këtë, t'u kërkonte palëve, në bazë të rregullës 94(2)(c) dhe (6) të Rregullores, të paraqisnin propozimet e tyre për zhdëmtimet që duhej t'i akordoheshin V01/10-ës.¹⁹¹

¹⁸⁹ Vendimi i 29 Janarit 2025, para. 18.

¹⁹⁰ Vendimi i 29 Janarit 2025, para. 23-31 dhe referencat e tjera në to.

¹⁹¹ Vendimi i 29 Janarit 2025, para. 38-40.

B. MARRËVESHJA MES PALËVE PËR ZHDËMTIMET

108. Palët parashtrojnë se të akuzuarit u pajtuan t'i paguajnë 500 euro V01/10-ës si zhdëmtim, dhe më saktësisht që z. Shala të paguajë 400 euro, z. Januzi të paguajë 100 euro dhe z. Bahtijari të mos bëjë asnjë pagesë.¹⁹²

C. PËRCAKTIMI I SHUMAVE DHE KRYERJA E PAGESAVE

109. Trupi Gjykues ka mbajtur parasysh marrëveshjen për zhdëmtimet të arritur mes palëve dhe të përfshirë në Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë dhe vë në dukje se kjo marrëveshje është konfirmuar nga z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari gjatë seancës së 4 shkurtit 2025 (shumat e pranuar të zhdëmtimit).¹⁹³

110. Trupi Gjykues është bindur se shumat e pranuar të zhdëmtimit, si pjesë e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë dhe këtij vendimi, ofrojnë deri në njëfarë mase pranim të dëmit të shkaktuar V01/10-ës nga personat e shpallur fajtorë, si dhe njohje të dëmit mendor, në formën e ankthit, të pësuar nga kjo viktimë.

111. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues udhëzon personat e shpallur fajtorë t'i paguajnë 500 euro V01/10-ës si zhdëmtim. Më konkretisht, z. Shala dhe z. Januzi do të paguajnë përkatësisht 400 euro dhe 100 euro, ndërsa z. Bahtijari nuk do të bëjë asnjë pagesë.

112. Pagesat duhet të bëhen jo më vonë se të mërkurën, 19 shkurt 2025. Për këtë qëllim, Administratorja udhëzohet të përcaktojë një llogari bankare dhe të informojë z. Shala dhe z. Januzi se si t'i kryejnë pagesat përkatëse të tyre. Në lidhje me këtë,

¹⁹² Shtesa e Marrëveshjeve për Pranimin e Fajësisë, para. 1; Shtojca 1 e Parashtrimeve të Palëve në lidhje me Zhdëmtimet, para. 1.

¹⁹³ Shtojca 1 e Parashtrimeve të Palëve në lidhje me Zhdëmtimet, para. 1; transkripti i 4 shkurtit 2025, f. 611, rreshti 13 deri në f. 612, rreshti 13.

Administratorja mund ta ndihmojë V01/10-en, ndër të tjera, me emërimin e një mbrojtësi, nëse kjo është dëshira e V01/10-ës. Administratorja gjithashtu udhëzohet t'i raportojë Trupit Gjykses, jo më vonë se të mërkurën, 19 shkurt 2025, nëse shuma është paguar në llogarinë bankare të caktuar dhe vetë V01/10-ës.¹⁹⁴

VIII. PËRFUNDIM

113. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë.

IX. VENDIM

114. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë;
- b. **SHPALL HAXHI SHALËN FAJTOR** për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe frikësim gjatë procedurës penale, të ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 31, 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe **E DËNON** atë me dënim të njësuar prej tre (3) vjetësh burgim;
- c. **SHPALL SABIT JANUZIN FAJTOR** për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe frikësim gjatë procedurës penale, të ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 31, 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe

¹⁹⁴ KSC-BC-2023-10, F00684, Administratorja, *Raport i Administratores mbi Pagesën e Zhdëmtimeve*, 19 shkurt 2025, publik. Trupi Gjykses thekson se pagimi i shumave të pranuara të zhdëmtimit u krye më 17 shkurt 2025, në përputhje me udhëzimet e tij (transkripti i 4 shkurtit 2025, f. 617, rreshti 25 deri në f. 618, rreshti 9). Rrjedhimisht, vendimi i mëposhtëm nuk përfshin një urdhër në lidhje me pagesën e zhdëmtimeve që janë kryer tashmë në datën e lëshimit të këtij vendimi.

neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe **E DËNON** atë me dënim të njësuar prej dy (2) vjetësh burgim; dhe

- d. **SHPALL ISMET BAHTIJARIN FAJTOR** për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe frikësim gjatë procedurës penale, të ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 31, 387 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe **E DËNON** atë me dënim të njësuar prej dy (2) vjetësh burgim;
- e. **THEKSON** se, na bazë të rregullës 94(8) të Rregullores, vendimi i Trupit Gjykues mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë ka fuqinë ligjore të një aktgjykimi të formës së prerë dhe kushtëzohet vetëm prej rihapjes së procedimit penal në bazë të nenit 48(1)-(3) të Ligjit dhe rregullës 187 të Rregullores; dhe
- f. **VENDOS** të ruajë juridiksionin për të gjitha qëllimet e tjera të nevojshme në këtë çështje.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 27 shkurt 2025

Në Hagë, Holandë.